



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE E PROJEKTEVE ME DONATORËT**

Nr. 5233 prot.

Himarë, më 16.07 . 2026

Lënda: Dërgim projektvendimi për miratim

**KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË,**

✓  
Himarë

Të nderuar Këshilltarë,

Përmes kësaj shkrese, përcjell kërkesën për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) me seli në Tiranë, për zbatimin e projektit “Olive Heritage Himara”, të propozuar nga fondacioni “Rruga me pisha”.

Bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni:

1. Projektvendimin për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), për zbatimin e projektit “Olive Heritage Himara”, të propozuar nga fondacioni “Rruga me pisha”.
2. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).
3. Relacionin shpjegues
4. Projekt propozimin.

**DREJTORI**

Valbona Avdullaj

**KRYETARI**

Vangjel Tavo

**NË MUNGESË, ME URDHËR DHE ME DELEGIM**

**ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE E PROJEKTEVE ME DONATORËT

Nr. 5233/prot.  
4

Himarë, më 16.07. 2026

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 45, Datë 16.07.2026

**PËR**

**“MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË HIMARË DHE PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP), PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “OLIVE HERITAGE HIMARA”, TË PROPOZUAR NGA FONDACIONI “RRUGA ME PISHA”**

Në mbështetje të Kushtetutës, të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.6, shkronja “a”, nenit 22, pika 1 dhe 2, nenit 25, pika 1, nenit 28, pika 1 e 4, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 119, Bashkia Himarë me propozim të Kryetarit të Bashkisë me qëllim realizimin e projekteve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe forcimin e kapaciteteve vendore,

**VENDOSI**

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara Për Zhvillim (UNDP), për zbatimin e projektit “Olive Heritage Himara”, të propozuar nga fondacioni “Rruga me pisha”.
2. Dhënien e miratimit Kryetarit të Bashkisë Himarë për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara Për Zhvillim (UNDP).

**KRYETARI**  
**Vangjel Tavo**

**NË MUNGESË, ME URDHËR DHE ME DELEGIM**  
**ZËVENDESKRYETARI**  
**Erifil Berberi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE E PROJEKTEVE ME DONATORËT

Nr. 5233/2 prot.

Himarë, më 16.07. 2026

## RELACION

### **“MBI PROJEKTVENDIMIN PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË HIMARË DHE PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP), PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “OLIVE HERITAGE HIMARA”, TË PROPOZUAR NGA FONDACIONI “RRUGA ME PISHA”**

Të nderuar Këshilltarë,

Qëllimi i këtij projektvendimi është miratimi nga Këshilli Bashkiak i Marrëveshjes ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Himarë për zbatimin e projektit “Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për SDG-të”, në kuadër të së cilit do të realizohet nisma pilot “Olive Heritage Himara”. Marrëveshja synon të mbështesë zhvillimin ekonomik vendor përmes promovimit të trashëgimisë së ullirit, zhvillimit të agroturizmit, rritjes së dukshmërisë së prodhuesve vendas të vajit të ullirit dhe krijimit të produkteve turistike të qëndrueshme në territorin e Bashkisë Himarë.

Kjo nismë pilot është miratuar të financohet në masën 60% nga bashkia Himarë dhe përmes kësaj marrëveshjeje kërkohet mbështetja shtesë prej 40% të buxhetit total për të zbatuar projektin në fjalë, i cili paraqet një mundësi risi për zhvillimin e qëndrueshëm rural, i projektuar për të zgjatur sezonin turistik gjatë muajve të vjeshtës dhe dimrit, duke shfrytëzuar trashëgiminë e pasur të ullirit në rajon.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, UNDP si donator do të vërë në dispozicion të Bashkisë Himarë fondin prej **2,000,000 lekë** për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në planin e punës dhe buxhetin e projektit, të detajuar si më poshtë:

- koordinimin vendor dhe ofrimin e ekspertizës për zbatimin e projektit;
- angazhimin e ekspertëve vendas;
- sigurimin e pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për aktivitetet;
- prodhimin e materialeve dokumentuese dhe promovuese;
- organizimin e aktivitetit për promovimin e vajit të ri të ullirit.


Projekti do të zbatohet nga Fondacioni "Rruga me pisha" në Vuno, Pilur, Dhërmi dhe Himarë gjatë harkut kohor prej muajve tetor-dhjetor 2026. Turistë të moshës 25–65 vjeç, të interesuar për turizmin e ngadaltë (slow tourism) dhe për të përfutur përvoja autentike kulturore dhe/apo bujqësore do të jenë grupi i synuar, të cilët do të bashkëveprojnë me komunitetin lokal për prodhimin e produktit autentik lokal të vajit të ullirit.

Bashkia Himarë, si përfitues i grantit nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) do të mbikëqyrë zbatimin e aktiviteteve të sipërcituara, të cilat do të realizohen nga fondacioni "Rruga me pisha".

## **DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE E PROJEKTEVE ME DONATORËT**

**DREJTORI**

Valbona Avdullaj





**MARRËVESHJA  
NDËRMJET  
PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM  
DHE  
BASHKISË SË HIMARËS  
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT BASHKËPUNIMI ME SIPËRMARRJEN DHE ZGJIDHJET  
PËR SDG-TË  
KU UNDP KA ROLIN E PALËS ZBATUESE**

I nderuar z. Vangjel Tavo, Kryetar i Bashkisë së Himarës,

1. U referohemi konsultimeve ndërmjet nëpunësve të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim ("UNDP") në Shqipëri dhe nëpunësve të Bashkisë së Himarës ("Pala Përgjegjëse"), në kuadër të zbatimit të projektit numër 01001859, Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për SDG-të. Dokumenti i Projektit/Portofolit është bashkëlidhur si Shtojca A dhe mund të ndryshohet herë pas here nga palët ("Projekti/Dokumenti i Portofolit").
2. Në përputhje me Dokumentin e Projektit dhe termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje, Pala Përgjegjëse ndërmerr aktivitetet e specifikuar në Shtojcën B (*Përshkrimi i Aktiviteteve*) ("Aktivitetet").
3. Pala Përgjegjëse është plotësisht përgjegjëse për kryerjen e Aktiviteteve me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, në përputhje me kalendarin e përcaktuar në Shtojcën B (*Përshkrimi i Aktiviteteve*) dhe në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje. Pala Përgjegjëse ndërmerr Aktivitetet në përputhje me rregulloret, rregullat dhe procedurat e tjera financiare, në masën që përputhen me Rregulloret dhe Rregullat e UNDP-së. Në rast se ato nuk përputhen, Pala Përgjegjëse zbaton Rregulloret dhe Rregullat Financiare të UNDP-së.
4. Pala Përgjegjëse pranon se mund t'i nënshtrohet një vlerësimi kapacitetesh sipas kërkesave të rregulloreve, rregullave dhe politikave të UNDP-së, duke përfshirë Politikën e qasjes së harmonizuar të UNDP-së për transfertat e parave ("HACT"), për të siguruar se ka kapacitet e nevojshme për të kryer Aktivitetet dhe se mund të menaxhojë dhe raportojë mbi fondet e transferuara nga UNDP-ja, sipas rastit. Vlerësimi i kapaciteteve do të kryhet nga një ofrues shërbimi i kualifikuar i palëve të treta, përzgjedhur nga UNDP-ja dhe UNDP-ja do t'i përdorë rezultatet për të përcaktuar mënyrën se si transfertat e parave do të bëhen nga Pala Përgjegjëse. UNDP-ja do të diskutojë rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve me Palën Përgjegjëse dhe do të bien dakord lidhur me masat për trajtimin e shqetësimeve të ngritura. Pala Përgjegjëse ofron bashkëpunimin e saj të plotë dhe në kohë për kryerjen e vlerësimit të kapaciteteve. Ky bashkëpunim



përfshin, por pa u kufizuar, detyrimin e Palës Përgjegjëse për të vënë në dispozicion personelin dhe dokumentacionin përkatës për këtë qëllim, në kohë të arsyeshme dhe me kushte të arsyeshme, si dhe për t'i dhënë akses ofruesit të shërbimit në mjediset e Palës Përgjegjëse dhe të përfaqësuesve të vet, në kohë të arsyeshme dhe me kushte të arsyeshme, për qëllimin e kryerjes së vlerësimit të kapaciteteve.

5. Sa u përket Aktiviteteve që do të zbatojë dhe produkteve të dorëzueshme të Projektit ose Planit(eve) të Punës të Portofolit (sipas rastit) për të cilat është përgjegjëse, Pala Përgjegjëse deklaron se ka lexuar dhe bie dakord të respektojë *mutatis mutandis* detyrimet dhe marrëveshjet e përcaktuara në Dokumentin e Projektit/Portofolit dhe shtojcat përkatëse, siç zbatohet për Palën Zbatuese, ose për çdo palë të kontraktuar nga Pala Zbatuese. Këto detyrime përfshijnë ato të përcaktuara në seksionin me titull "Menaxhimi i Riskut", që përmban dispozitat lidhur me zbatimin e politikave të UNDP-së për shfrytëzimin seksual, abuzimin seksual dhe ngacmimin seksual, si dhe standardet sociale dhe mjedisore, duke përfshirë mekanizmat e ankesave, ndalimin e shpërdorimit të fondeve, mashtrimit dhe korrupsionit, masat kundër pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit.

6. Të gjitha informacionet ose të dhënat e dhëna nga Pala Përgjegjëse për UNDP-në me qëllimin e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, si dhe cilësia e Aktiviteteve dhe raporteve të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jenë në përputhje me standardet më të larta profesionale.

7. Palët informojnë njëra-tjetrën rregullisht dhe konsultohen për çështjet e lidhura me zbatimin e Aktiviteteve.

#### **Marrëveshjet financiare**

8. Në përputhje me Dokumentin e Projektit/Portofolit, UNDP-ja ka alokuar dhe do t'i vërë në dispozicion Palës Përgjegjëse fondet, të cilat nuk tejkalojnë buxhetin për Aktivitetet siç përcaktohet në Shtojcën C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*). Transferta e parë e parave në shumën e përcaktuar në Shtojcën C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*) dhe çdo transfertë pasardhëse parash bëhet çdo tre muaj pas dorëzimit të përshtatshëm dhe miratimit nga UNDP-ja të formularit FACE dhe të dokumenteve të tjera të dakordësuara, të referuara në Nenin 20 (*Kërkesat e Raportimit*) më poshtë. Përpara miratimit të transfertave të parave, UNDP-ja siguron që shumat e kërkuara nga Pala Përgjegjëse të jenë në përputhje me Planin e Punës.

9. Shuma maksimale e buxhetit për Aktivitetet, siç përcaktohet në Shtojcën C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*) nuk u nënshtrohen përshtatjeve ose rishikimit për asnjë arsye, duke përfshirë luhatjet në valutë ose çmim, ose kostot e hasura nga Pala Përgjegjëse në zbatim të Aktiviteteve.



10. UNDP-ja bën të gjitha pagesat në llogarinë bankare të Palës Përgjegjëse, si më poshtë:

Emri i llogarisë: [Click here and enter Owner of Bank Account]

Numri i llogarisë: [Click here and enter Account Number]

Emri i bankës: [Click here and enter Bank name]

Adresa e bankës: [Click here and enter Bank Address]

Kodi bankar SWIFT: [Click here and enter Bank SWIFT Code]

Kodi bankar: [Click here and enter Bank Code]

Udhëzimet e drejtimit për disbursimet: [Click here and enter any additional instructions]

11. Pagesat e kryera nga UNDP-ja për Palën Përgjegjëse nuk e lirojnë këtë të fundit nga detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe as nuk konsiderohen si pranim nga UNDP-ja i kryerjes së Aktiviteteve nga Pala Përgjegjëse.

12. Pala Përgjegjëse nuk ndërmerr angazhime financiare apo nuk kryen shpenzime që tejkalojnë buxhetin për Aktivitetet siç përcaktohen në Shtojcën C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*). Pala Përgjegjëse konsultohet rregullisht me UNDP-në lidhur me gjendjen dhe përdorimin e fondeve, si dhe informon menjëherë UNDP-në në rast se Pala Përgjegjëse merr dijeni se buxheti për zbatimin e Aktiviteteve sipas Shtojcës B (*Përshkrimi i Aktiviteteve*) është i pamjaftueshëm. UNDP-ja nuk ka asnjë detyrim për t'i dhënë fonde Palës Përgjegjëse apo për t'i kompensuar kësaj të fundit shpenzimet e veta, që shkojnë përtej totalit të buxhetit të përcaktuar në Shtojcën C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*).

13. UNDP-ja nuk është përgjegjëse për pagesën e shpenzimeve, tarifave, pagesave, ose çdo kostoje tjetër që nuk paraqitet shprehimisht në Dokumentin e Projektit/Portofolit ose që tejkalon shumën maksimale të buxhetit për Aktivitetet siç përcaktohet në Shtojcën C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*).

14. **Auditimi:** (a) UNDP-ja mund t'i kërkojë Palës Përgjegjëse t'i dorëzojë Përfaqësuesit të Përhershëm të UNDP-së në Shqipëri pasqyra financiare vjetore të audituara dhe çdo letër menaxhimi të lëshuar nga audituesit. Auditimi kryhet nga audituesit e Palës Përgjegjëse ose nga një firmë e kualifikuar auditimi të angazhuar nga Pala Përgjegjëse, që do të përgatisë një raport auditimi për pasqyrat financiare.

(b) Pavarësisht sa më sipër, UNDP-ja ka të drejtë, në përputhje me Rregulloret dhe Rregullat e veta Financiare, të kryejë një auditim vjetor ose një auditim që kryhet vetëm një herë, lidhur me Projektin ose Portofolin (sipas rastit) ose të rishikojë librat dhe të dhënat për Projektin/Portofolin dhe për këtë qëllim, UNDP-ja ka akses të plotë në librat dhe të dhënat e Palës Përgjegjëse. Këto auditime do të pasqyrohen në planin vjetor të auditimit të përgatitur nga UNDP-ja në konsultim me Palën Përgjegjëse, dhe kostoja e këtyre auditimeve dhe rishikimeve i ngarkohet Projektit ose Portofolit (sipas rastit). Auditimet do të kryhen nga auditues të



përzgjedhur nga UNDP-ja dhe sipas standardeve, fushëveprimit dhe shpeshtësisë së vendosur nga UNDP-ja. Fushëveprimi i auditimeve do të përfshirë transaksionet financiare dhe kontrollet e brendshme të lidhura me Aktivitetet.

**15. Rimbursimi:** (a) Pala Përgjegjëse disburson fondet që ia janë vënë në dispozicion nga UNDP-ja dhe Shpenzimet e bëra në lidhje me Aktivitetet në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, duke përfshirë planin e punës në Shtojcën C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*). Në rast se Pala Përgjegjëse disburson fondet ose Shpenzimet e bëra në shkelje të Marrëveshjes, duke përfshirë planin e punës, pavarësisht disponueshmërisë ose përdorimit të mjeteve të tjera në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, Pala Përgjegjëse i rimbursion shumat UNDP-së jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pasi Pala Përgjegjëse të marrë kërkesën me shkrim për këtë rimbursim nga UNDP-ja. Në rast mospërmblidhjeje, UNDP-ja mund të kompensojë shumën e kërkuar për rimbursim kundrejt çdo pagese ndaj Palës Përgjegjëse sipas kësaj Marrëveshjeje. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, “Shpenzimet” janë disbursimet e bëra dhe detyrimet e vlefshme pezull të hasura lidhur me mallrat dhe shërbimet e kryera.

(b) Përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe me shkrim nga UNDP-ja, Pala Përgjegjëse i kthen të gjitha fondet e pashpenzuara dhe të ardhurat UNDP-së brenda një (1) muaji nga kryerja e Aktiviteteve ose përfundimi i kësaj Marrëveshjeje, cilado që të ndodhë më herët.

## **Personeli**

**16.** Gjatë kryerjes së Aktiviteteve, nënperfituesit e Palës Përgjegjëse ose subjektet e tjera të përfshira në Projekt ose në Planin(et) e Punës të Portofolit si kontraktorë ose nënkontraktorë dhe personeli i tyre dhe të gjithë individët që kryejnë shërbime për ta në kuadër të kësaj Marrëveshjeje (“Personeli”) nuk konsiderohen në asnjë aspekt punonjës apo përfaqësues të UNDP-së.

**17.** UNDP-ja nuk mban përgjegjësi lidhur me pretendime ligjore që lindin nga veprime apo mosveprime nga ana e Palës Kontraktuese apo Personelit të saj gjatë kryerjes së Aktiviteteve sipas projektit; apo ndonjë pretendim ligjor për vdekje, lëndim trupor, paafësi, dëme në pronë apo rreziqe të tjera që mund të pësojë Pala Përgjegjëse apo Personeli saj si pasojë e punës që kryen lidhur me zbatimin e Aktiviteteve. Pala Përgjegjëse siguron që të gjitha detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje të vlejnjë për të gjithë Personelin.

**18.** I gjithë Personeli punon nën mbikëqyrjen e nëpunësit të emëruar të Palës Përgjegjëse. Personeli mban përgjegjësi para Palës Përgjegjëse për mënyrën për mënyrën e kryerjes së funksioneve të caktuara.



19. Pala Përgjegjëse është tërësisht përgjegjëse për të gjitha aktivitetet e kryera nga Personeli dhe siguron që të gjitha detyrimet e veta në kuadër të kësaj Marrëveshjeje të vlejné edhe për Personelin.

## 20. Kërkesat e Raportimit

(a) Sa i përket zbatimit të Aktiviteteve sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala Përgjegjëse i paraqet UNDP-së raporte progresi në lidhje me Aktivitetet, të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga menaxheri i Projektit ose Portofolit (sipas rastit) gjatë ushtrimit të detyrave të veta.

(b) Pala Përgjegjëse dorëzon një Formular FACE të plotësuar, i cili mund të aksesohet në linkun e mëposhtëm: [UNSDG | Funding Authorization and Certificate of Expenditures Form](#) ("Formulari FACE"), duke përfshirë një vlerësim të kostove për zë që tregon buxhetin e detajuar të aktivitetit dhe shpenzimet konkrete për Përfaqësuesin e Përhershëm jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori. Të gjithë Formularët FACE të dorëzuar nga Pala Përgjegjëse miratohen nga nëpunësi i autorizuar sipas specifikimeve në Shtojcën D (*Formulari i Modeleve të Nënshkrimit*). Përpara miratimit të disbursimit të fondeve, UNDP-ja siguron që transfertat e parave të kërkuara nga Pala Përgjegjëse të jenë në përputhje me dispozitat e Shtojcës C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*).

(c) Pala Përgjegjëse paraqet një raport përfundimtar jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit apo ndërprerjes së Aktiviteteve, ku do të përfshihet një listë e pajisjeve të blera nga Pala Përgjegjëse si dhe të gjithë regjistrat përkatës, që lidhen me Aktivitetet, sipas rastit, bazuar në rregulloret dhe rregullat e veta financiare.

(d) UNDP-ja ka të drejtë, në përputhje me Rregulloret, Rregullat dhe Procedurat e veta Financiare, të kryejë aktivitete verifikimi (assurance) të lidhura me librat dhe regjistrat e lidhura me Projektin/Portofolin, në përputhje me Politikën e HACT-së, për të vlerësuar përdorimin e fondeve të ofruara nga UNDP-ja dhe plotësinë dhe saktësinë e raporteve financiare të dorëzuara nga Pala Përgjegjëse. Aktivitetet e verifikimit (assurance) sipas HACT-së do të pasqyrohen në planin e sigurimit të përgatitur nga UNDP-ja në konsultim me Palën Përgjegjëse dhe do të kryhen nga ofruesit e shërbimit palë të treta ose stafi i UNDP-së. Kostoja e aktiviteteve të sigurimit sipas HACT-së i ngarkohet Projektit ose Portofol-it (sipas rastit).

## 21. Dokumentimi

(a) Pala Përgjegjëse mban regjistra dhe dokumente të sakta dhe të përditësuara në lidhje me të gjitha transaksionet e kryera me fondet e vëna në dispozicion nga UNDP-ja për të siguruar që të gjitha transaksionet janë kryer sipas dispozitave të Shtojcës C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*). Për çdo disbursim



ruhet dokumentacioni i duhur mbështetës, duke përfshirë arkëtimet, faturat dhe fletëngarkesat origjinale. Pala Përgjegjëse mban regjistra të saktë dhe të përditësuar, si dhe dokumente për të gjitha të ardhurat e gjeneruara me fondet e vëna në dispozicion nga UNDP-ja dhe ia tregon menjëherë UNDP-së. Të ardhurat pasqyrohen në një plan pune dhe buxhet të rishikuar sipas përcaktimeve në Shtojcën C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*) dhe të regjistruar si të ardhura të mbledhura për UNDP-në. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, "Të Ardhurat" janë interesi mbi fondet e Projektit ose Portofolit (sipas rastit) dhe të gjitha të ardhurat e marra nga përdorimi ose shitja e pajisjeve dhe mjeteve kapitale të blera me fondet e ofruara nga UNDP-ja ose të ardhurat e gjeneruara nga produktet ose aktivitetet e Projektit ose Portofolit (sipas rastit).

(b) Pala Përgjegjëse ruan të gjithë regjistrat përkatës për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit ose Portofolit (sipas rastit) për të paktën (7) vjet pas përfundimit të Projektit ose të Planit(eve) të Punës të Portofolit (sipas rastit) ose pas ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje.

**22. Pajisjet:** Pajisjet e siguruara nga UNDP-ja ose të prokuruarat përmes fondeve të UNDP-së do të asgjësohen në përputhje me kërkesat e marrëveshjes ndërmjet UNDP-së dhe institucionit Qeveritar të përfshirë. Në rastin e ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje, çdo Pajisje e tillë do t'i kthehet UNDP-së brenda tridhjetë (30) ditëve. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, "Pajisjeje" do të thotë çdo mjet jo i konsumueshëm, pajisje, automjet dhe material i blerë, të financuara nga UNDP-ja ose të siguruara nga UNDP-ja për Palën Përgjegjëse në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

**23. Të drejtat pronësore:** Pronësia mbi të drejtat e patentave, të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të ngjashme për çdo zbulim, shpikje ose vepër që rezulton nga zbatimi i Aktiviteteve i kalon UNDP-së.

#### **24. Konfidencialiteti**

(a) Informacioni dhe të dhënat, duke përjashtuar të Dhënat Personale të UNDP-së (siç përcaktohet në Nenin 25 (a) më poshtë), që jepen ose ndahen nga një Palë ("Pala Informuese") për Palën tjetër ("Pala Marrëse") gjatë kohëzgjatjes së Aktiviteteve dhe që janë përcaktuar si konfidenciale në kohën e këmbimit ose janë identifikuar me shkrim, pa vonesa, si konfidenciale gjatë sigurimit në formë jomateriale, ose janë ndarë gojashit, si dhe informacionet që Pala Marrëse e di ose duhej ta kishte ditur, për shkak të natyrës, cilësisë ose karakteristikave të qenësishme, se janë konfidenciale ose pronësore ("Informacionet") ruhen në mënyrë konfidenciale nga Pala Marrëse dhe trajtohen si më poshtë:



(b) Përfituesi:

(i) tregon kujdes dhe diskrecion për të shmangur ndarjen, publikimin ose shpërndarjen e Informacioneve të Palës Informuese, njësoj siç përdor Informacionet e veta, të cilat nuk dëshiron t'i ndajë, publikojë ose shpërndajë; dhe

(ii) përdor Informacionet e Palës Informuese vetëm për qëllimin për të cilin u ndanë.

(c) Me kusht që Pala Marrëse të ketë një marrëveshje me shkrim me personat ose subjektet e mëposhtme, ku kërkon që Informacionet konfidenciale të trajtohen në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, Pala Marrëse mund t'i ndajë Informacionet:

(i) për çdo palë tjetër me pëlqimin paraprak me shkrim të Palës Informuese;

(ii) për punonjësit, nëpunësit, përfaqësuesit dhe agjentët e Palës Marrëse, që duhet t'i dinë Informacionet për qëllimet e përmbushjes së detyrimeve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, si dhe punonjësit, nëpunësit, përfaqësuesit dhe agjentët e çdo subjekti ligjor, që kontrollojnë, e kontrollojnë, ose me të cilin ka kontroll të ndërsjellë, që duhet t'i dijë këto Informacione për qëllimet e përmbushjes së detyrimeve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje;

(iii) për qëllimet e Nenit 24 (c) (ii) më sipër, subjekti i kontrolluar ligjor është:

(a) një subjekt ligjor, në të cilin Pala zotëron ose kontrollojnë, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, mbi pesëdhjetë për qind (50%) të të drejtave të votës; ose

(b) një subjekt ligjor, mbi të cilin Pala ushtron kontroll efektiv menaxherial; dhe

(iv) për UNDP-në, një organ kryesor ose organ nën varësi të Kombeve të Bashkuara në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

(d) UNDP-ja mund të përcaktojë që çdo Informacion i ofruar nga UNDP-ja për Palën Përgjegjëse të jetë pjesë përbërëse e pronave dhe arkivave të UNDP-së sipas kuptimit të Konventës për Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara, 1 U.N.T.S. 15 (1946) ("Konventa e Përgjithshme") dhe Neni II i Konventës së Përgjithshme zbatohet për të gjitha këto Informacione.

(e) Pala Përgjegjëse mund të ndajë Informacione deri në masën e kërkuar me ligj, me kusht që, në përputhje me dhe pa heqje dorë nga privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara, Pala Përgjegjëse ta njoftojë paraprakisht UNDP-në për kërkesën për ndarje Informacioni në mënyrë që t'i ofrojë UNDP-së një mundësi të arsyeshme për të ndërmarrë masa mbrojtëse ose veprime të tjera, si të jetë e përshtatshme, përpara çdo ndarjeje.



(f) UNDP-ja mund të ndajë Informacione në masën e kërkuar në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, mbështetur në rezolutat ose rregulloret e Asamblesë së Përgjithshme ose rregullat e shpallura, ose sipas rregulloreve, rregullave, politikave dhe procedurave të UNDP-së.

(g) Pala Marrëse nuk përjashtohet nga ndarja e Informacioneve që i bëhet nga një palë e tretë pa kufizime, që i tregohet një palë të tretë nga Pala Informuese pa asnjë detyrim konfidencialiteti, që dihet më parë nga Pala Marrëse, ose që në çdo kohë është zhvilluar nga Pala Marrëse plotësisht në mënyrë të pavarur nga çdo ndarje.

(h) Këto detyrime dhe kufizime konfidencialiteti mbeten në fuqi gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë çdo shtesë dhe mbetet në fuqi edhe pas ndërprerjes ose skadimit të kësaj Marrëveshjeje.

## **25. Të dhëna personale**

(a) Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

(i) “Të Dhënat Personale” janë të gjitha informacionet që lidhen me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm.

(ii) “Të Dhënat Personale të UNDP-së” janë të Dhënat Personale të marra nga Pala Përgjegjëse prej UNDP-së ose të gjeneruara nga Pala Përgjegjëse për UNDP-në në lidhje me kryerjen e Aktiviteteve.

(b) Lidhur me të Dhënat Personale, që merr nga Pala Përgjegjëse në lidhje me këtë Marrëveshje, UNDP-ja:

(i) zbaton kuadrin e vet ligjor, duke përfshirë Politikën e UNDP-së për Privatësinë dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Parimet e UNDP-së për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

(ii) tregon kujdes dhe diskrecion për të shmangur ndarjen, publikimin ose shpërndarjen e të Dhënave Personale, njësoj siç përdor Informacionet e veta, të cilat nuk dëshiron t'i ndajë, publikojë ose shpërndajë; dhe

(iii) përdor të Dhënat Personale vetëm për qëllimin për të cilin u ndanë.

(c) Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, sa u përket të Dhënave Personale të UNDP-së, Pala Përgjegjëse vepron së paku si më poshtë:



- (i) vepron në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme për Palën Përgjegjëse;
  - (ii) zbaton Politikën e UNDP-së për Privatësinë dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Parimet e UNDP-së për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
  - (iii) tregon kujdes dhe diskrecion për të shmangur ndarjen, publikimin ose shpërndarjen e të Dhënave Personale të UNDP-së, njësoj siç përdor Informacionet e veta, të cilat nuk dëshiron t'i ndajë, publikojë ose shpërndajë; dhe
  - (iv) përdor të Dhënat Personale të UNDP-së vetëm për qëllimin për të cilin u ndanë.
- (d) Pa paragjykim për përgjithësinë e Nenit 25 (c) më sipër dhe përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, Pala Përgjegjëse vepron së paku si më poshtë:
- (i) përpunon të Dhënat Personale të UNDP-së vetëm dhe ekskluzivisht në përputhje me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje dhe nuk përdor të Dhënat Personale të UNDP-së për qëllime kërkimore, marketingu, promovuese ose për çdo qëllim tjetër të Palës Përgjegjëse;
  - (ii) zbaton masat e përshtatshme teknike dhe organizative, duke përfshirë masat e duhura për kontrollin e aksesit, në lidhje me të Dhënat Personale të UNDP-së;
  - (iii) zbaton masat e përshtatshme të sigurisë së të dhënave për të ruajtur integritetin e të Dhënave Personale të UNDP-së dhe parandalon çdo korrupsion, ndërhyrje, humbje, dëm, akses të paautorizuar dhe ndarje të papërshtatshme të të Dhënave Personale të UNDP-së;
  - (iv) mund t'ua tregojë të Dhënat Personale të UNDP-së vetëm punonjësve të vet, që duhet t'i dinë këto të Dhëna Personale të UNDP-së për qëllimet e përmbushjes së detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;
  - (v) përpunon të Dhënat Personale të UNDP-së në mënyrë të ligjshme, transparent, të duhur, të saktë, të përshtatshme dhe të kufizuar në atë sa është e nevojshme për kryerjen e Aktiviteteve dhe siguron që të Dhënat Personale të UNDP-së të mbahen për një kohë jo më të gjatë se sa nevojitet për kryerjen e Aktiviteteve;
  - (vi) si dhe kur kërkohet nga UNDP-ja, jep akses, korrigjon, fshin, nuk ndërmer veprime ose kufizon përpunimin e të Dhënave Personale të UNDP-së;
  - (vii) pasi të marrë dijeni për ndonjë shkelje për sigurinë ose të dhënat (duke përfshirë ndonjë shkatërrim aksidental ose të paautorizuar, humbje, modifikim, ndarje, akses ose humbje të paplanifikuar të disponueshmërisë) që prek ose mund të prekë të Dhënat Personale të UNDP-së:



- (a) njofton menjëherë UNDP-në me shkrim;
  - (b) ndërmerr veprime të menjëhershme zbutëse dhe/ose korrigjuese, duke përfshirë veprimet zbutëse dhe/ose korrigjuese sipas udhëzimeve të UNDP-së; dhe
  - (c) informon dhe përditëson rregullisht UNDP-në për çdo masë të ndërmarrë nga Pala Përgjegjëse për të trajtuar shkeljet e sigurisë ose të të dhënave;
- (viii) njofton menjëherë UNDP-në nëse beson se përmbushja e detyrimeve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje ose pajtueshmëria me udhëzimet e UNDP-së shkel, ose konsiderohet se mund të shkelë, legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave ose Politikën e Privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale të UNDP-së;
- (ix) nëse merr ndonjë ankesë, kërkesë (duke përfshirë kërkesën për akses në të dhënat e subjektit), njoftim, ose komunikim, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me të Dhënat Personale të UNDP-së:
- (a) njofton menjëherë UNDP-në;
  - (b) konsultohet dhe zbaton udhëzimet e UNDP-së në lidhje me trajtimin e ankesave, kërkesave, njoftimeve ose komunikimeve; dhe
  - (c) ofron bashkëpunim dhe ndihmë të plotë për UNDP-në, nëse UNDP-ja zgjedh t'u përgjigjet ankesave, kërkesave, njoftimeve ose komunikimeve;
- (x) kthen, fshin ose shkatërron të Dhënat Personale të UNDP-së nëse udhëzohet nga UNDP-ja me shkrim dhe pas kërkesës me shkrim të UNDP-së i paraqet kësaj "A fundit prova se i ka ndërmarrë këto veprime;
- (xi) shkatërron të gjitha të Dhënat Personale të UNDP-së 10 vjet pas datës në cilën skadon ose ndërpritet Marrëveshja, përveç rasteve kur UNDP-ja udhëzon ndryshe me shkrim.
- (e) Përveç rasteve të parashikuara në Nenin 25 (d) më sipër, Pala Përgjegjëse nuk transferon, ndan, publikon ose shpërndan të Dhënat Personale të UNDP-së pa pëlqimin paraprak me shkrim të UNDP-së.
- (f) Dispozitat e Nenit 25 vlejnë edhe pas ndërprerjes ose skadimit të kësaj Marrëveshjeje.

## 26. Zhdëmtimi

- (a) Pala Përgjegjëse dëmshpërblen, mbron, mban dhe ruan, pa dëmtuar, UNDP-në dhe nëpunësit,



përfaqësuesit dhe personat që kryejnë shërbime për UNDP-në nga paditë, procedimet, pretendimet, kërkesat, humbjet dhe përgjegjësitë e çdo lloji ose natyre të shkaktuara nga palë të treta kundrejt UNDP-së.

(b) Krahës detyrimeve për zhdëmtim të përcaktuara në Nenin 26, Pala Përgjegjëse detyrohet, me shpenzimet e veta, të mbrojë UNDP-në dhe nëpunësit, përfaqësuesit dhe punonjësit, mbështetur në Nenin 26, pavarësisht nëse paditë, procedimet, pretendimet dhe kërkesat përkatëse sjellin incidente ose rezultojnë në humbje ose përgjegjësi.

(c) UNDP-ja këshillon Palën Përgjegjëse për çdo padi, procedim, pretendim, kërkesë, humbje ose përgjegjësi brenda një periudhe kohore pas marrjes së njoftimit përkatës. Pala Përgjegjëse ka kontroll të vetëm mbi mbrojtjen lidhur me paditë, procedimet, pretendimet, kërkesat dhe të gjitha negociatat në lidhje me zgjidhjet ose kompromiset, përveçse sa i përket sigurimit ose mbrojtjes së privilegjeve dhe imuniteteve të UNDP-së ose çdo çështje të lidhur, për të cilat vetëm UNDP-ja është e autorizuar të sqarojë dhe të pohojë. UNDP-ja ka të drejtë, me shpenzimet e veta, të përfaqësohet në padi, procedime, pretendime ose kërkesa nga avokatë të pavarur sipas zgjedhjes së vet.

## **27. Forca Madhore**

(a) Në rast se ndodh një ngjarje e forcës madhore dhe sa më shpejt pas saj, Pala e prekur lajmëron Palën tjetër me shkrim me detaje të plota për një ngjarje të tillë. Nëse Pala e prekur nuk është më në gjendje, tërësisht ose pjesërisht, të përmbushë detyrimet ose përgjegjësitë e veta në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, Palët konsultohen për veprimet e përshtatshme që duhen ndërmarrë, që mund të përfshijnë pezullimin ose ndërprerjen, në mbështetje të Nenit 31 (*Pezullimi dhe Ndërprerja*) si më poshtë, por periudha e njoftimit është shtatë (7) ditë në vend të tridhjetë (30) ditëve në rast ndërprerjeje. Forca madhore e përkrahur këtu është çdo dukuri natyrore e paparashikueshme dhe e pakontrollueshme, çdo akt lufte (qoftë i deklaruar apo jo), akt qeverie, pushtim, revolucion, kryengritje, terrorizëm ose çdo veprim tjetër e natyrës ose forcës së ngjashme, duke përfshirë ndër të tjera, pandemitë ose epidemitë që prek aftësinë e Palëve për të përmbushur detyrimet, me kusht që këto akte të ndodhin për shkaqe që janë përtej kontrollit dhe nuk vijnë si rrjedhojë e fajit apo neglizhencës së Palës së prekur.

## **28. Përdorimi i emrit, emblemës dhe vulës zyrtare të UNDP-së**

(a) Pala Përgjegjëse përdor vetëm emrin (duke përfshirë shkurtesat), emblemën ose vulën zyrtare të Kombeve të Bashkuara ose UNDP-së në lidhje të drejtpërdrejtë me Aktivitetet dhe me pëlqimin paraprak me shkrim të UNDP-së. Në asnjë rrethanë pëlqimi për përdorimin e emrit (duke përfshirë shkurtesat),



emblemës ose vulës zyrtare të Kombeve të Bashkuara ose UNDP-së nuk jepet për qëllime tregtare ose vullnet të mirë.

(b) Palët bashkëpunojnë për çdo praktikë të lidhur me marrëdhëniet publike ose publicitetin, kur UNDP-ja e sheh të përshtatshme dhe të dobishme.

## **29. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

(a) Çdo mosmarrëveshje, mospajtim ose pretendim ndërmjet Palëve, që lind nga kjo Marrëveshje, ose nga shkelja, ndërprerja ose pavlefshmëria e saj ("Mosmarrëveshja") zgjidhet përfundimisht në mënyrën e përcaktuar në Nenin 29, që është detyrues për Palët dhe është mënyra ekskluzive e zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me Nenin VIII, Seksionin 29 të Konventës për Privilegjet dhe Imunitetet të Kombeve të Bashkuara, I U.N.T.S. 15 (1946).

*Mënyra 1: Nëse Pala është Ministri, përdorni mënyrën 1 dhe fshini mënyrën 2 më poshtë:*

(b) Çdo mosmarrëveshje mes UNDP-së dhe Palës Përgjegjëse që vjen si pasojë apo ka lidhje me këtë Marrëveshje dhe që nuk zgjidhet përmes negociatave apo rrugëve të tjera të pranura të zgjidhjes, i paraqitet për arbitrazh njëres prej Palëve. Secila Palë emëron një arbitër dhe të dy arbitrat e emëruar në këtë mënyrë emërojnë arbitrin e tretë, që caktohet kryetar. Nëse njëra prej Palëve nuk ka emëruar një arbitër brenda tridhjetë (30) ditëve nga kërkesa për arbitrazh, ose nëse arbitri i tretë nuk është emëruar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga emërimi i dy arbitrave, secila prej Palëve mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të caktojë një arbitër. Procedura e arbitrazhit përcaktohet nga arbitrat dhe shpenzimet e arbitrazhit mbulohen nga Palët sipas përcaktimeve të arbitrave. Vendimi i arbitrazhit përmban një parashtrim të arsyeve mbi bazën e të cilave është marrë dhe pranohet nga Palët si vendim i formës së prerë për mosmarrëveshjen.

**30. Privilegjet dhe imunitetet:** Asgjë në këtë Marrëveshje, ose në lidhje me të, nuk konsiderohet heqje dorë, e shprehur ose e nënkuptuar, nga privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë UNDP-në.

## **31. Pezullimi dhe ndërprerja**

(a) Palët pranojnë se zbatimi dhe përfundimi i suksesshëm i Aktiviteteve janë të rëndësishëm dhe se UNDP-ja mund ta shohë të nevojshme të pezullojë ose ndërpresë këtë Marrëveshje, ose të modifikojë Aktivitetet, nëse lindin rrethana që rrezikojnë përfundimin e suksesshëm të Projektit ose Planit(ve) të Punës



të Portofolit (sipas rastit). Dispozitat e Nenit 31 zbatohen për pezullimin dhe ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitat e Nenit 32 (*Modifikimet; Njoftimet*) më poshtë zbatohen për modifikimin e Aktiviteteve.

(b) UNDP-ja konsultohet me Palën Përgjegjëse nëse lindin rrethana, që sipas gjykimit të UNDP-së, ndërhyjnë ose kërcënojnë të ndërhyjnë në zbatimin e suksesshëm ose përfundimin e Aktiviteteve. Nga ana e saj, Pala Përgjegjëse informon menjëherë UNDP-në për çdo rrethanë për të cilën merr dijeni. Palët bashkëpunojnë për korrigjimin ose eliminimin e rrethanave në fjalë dhe bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për këtë qëllim, duke përfshirë marrjen e hapave të menjëhershëm korrigjues nga Pala Përgjegjëse, kur rrethana të tilla i atribuohen asaj ose janë nën përgjegjësinë ose kontrollin e saj. Gjithashtu, Palët bashkëpunojnë për vlerësimin e pasojave të ndërprerjes së mundshme të kësaj Marrëveshjeje mbi përfituesit e Projektit ose Planit(eve) të Punës të Portofolit (sipas rastit).

(c) UNDP-ja mundet, në çdo kohë pas ndodhjes së rrethanave të lartpërmendura, ta pezullojë këtë Marrëveshjeje me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës Përgjegjëse pa cenuar fillimin ose vazhdimin e ndonjëres prej masave të parashikuara në Nenin 31 (b) më sipër. Pavarësisht Nenit 31 (a) më sipër, gjatë periudhës së pezullimit, nuk mund të kryhen shpenzime nëse nuk miratohen paraprakisht nga UNDP-ja. UNDP-ja mund t'i tregojë Palës Përgjegjëse kushtet sipas të cilave është e përgatitur të autorizojë rifillimin e Aktiviteteve.

(d) Nëse shkaku i pezullimit nuk korrigjohet ose eliminohet brenda katërmëdhjetë (14) ditëve pasi UNDP-ja i ka bërë njoftimin për pezullim Palës Përgjegjëse, UNDP-ja mund ta përfundojë këtë Marrëveshjeje me njoftim me shkrim në çdo moment gjatë vijimit të ngjarjes. Data e hyrjes në fuqi të ndërprerjes sipas dispozitave të Nenit 31 (d) do të specifikohet me njoftim me shkrim nga UNDP-ja. Me marrjen e një njoftimi ndërprerjeje nga UNDP-ja sipas Nenit 31, Pala Përgjegjëse merr masa të menjëhershme për të ndërprerë Aktivitetet e veta në kuadër të Marrëveshjes në mënyrë të rregullt dhe të menjëhershme për të minimizuar humbjet dhe Shpenzimet e mëtejshme. Pala Përgjegjëse nuk ndërmerr asnjë angazhim të mëtejshëm dhe i kthen UNDP-së, brenda tridhjetë (30) ditëve, të gjitha fondet e pashpenzuara të vënë në dispozicion nga UNDP-ja sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe Pajisjet e financuara ose të siguruara nga UNDP-ja sipas Nenit 19 (*Pajisjet*) më poshtë.

(e) Në vijim të përfundimit, në rast se UNDP-ja vendos t'ia kalojë përgjegjësitë e Palës Përgjegjëse për Aktivitetet një subjekti tjetër, Pala Përgjegjëse bashkëpunon me UNDP-në dhe subjekte të tjera për të siguruar kalimin e rregullt të përgjegjësisë.



(f) Pavarësisht sa më sipër, UNDP-ja mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë, pa shprehur arsyen deri në gjashtëdhjetë (60) ditë përpara me njoftim me shkrim drejtuar Palës Përgjegjëse.

(g) Pala Përgjegjëse mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në rast se ka lindur një situatë që e pengon atë t'i përmbushë me sukses përgjegjësitë e veta sipas Marrëveshjes, duke njoftuar UNDP-në me shkrim se synon të ndërpresë Marrëveshjen aktuale (i) të paktën tridhjetë (30) ditë përpara datës së hyrjes në fuqi të ndërprerjes nëse Projekti ose Portofoli (sipas rastit) ka një kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh ose më pak, ose (ii) të paktën gjashtëdhjetë (60) ditë përpara hyrjes në fuqi të ndërprerjes nëse Projekti ose Portofoli (sipas rastit) ka një kohëzgjatje prej më shumë se gjashtë (6) muajsh.

(h) Lidhur me Nenin 31 (g) më sipër, Pala Përgjegjëse mund të njoftojë për ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje vetëm pasi të jenë zhvilluar konsultime midis Palës Përgjegjëse dhe UNDP-së, me qëllim eliminimin e pengesës dhe u kushton vëmendje të duhur propozimeve të bëra nga UNDP-ja për këtë çështje.

(i) Në rast të ndërprerjes nga UNDP-ja sipas këtij Neni 31, UNDP-ja do të rimbursojë Palën Përgjegjëse vetëm për Shpenzimet e bëra nga Pala Përgjegjëse para marrjes së njoftimit të ndërprerjes. Rimbursimet për Palën Përgjegjëse sipas kësaj dispozite, kur u shtohen shumave të vëna më parë në dispozicion për Palën Përgjegjëse nga UNDP-ja në përputhje me këtë Marrëveshje, nuk tejkalojnë shumën maksimale të fondeve të specifikuar në buxhet për Aktivitetet sipas Shtojcës C (*Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave*).

## **32. Modifikimet; Njoftimet**

(a) Asnjë modifikim ose ndryshim në këtë Marrëveshje nuk është i vlefshëm dhe i zbatueshëm ndaj Palëve, përveç rasteve kur ekzekutohet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.

(b) Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim i kërkuar ose i lejuar për t'u dhënë ose për t'u bërë në përputhje me këtë Marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe do t'i drejtohet Randi Davis, Përfaqësuesit të Përhershëm, Rruga "Skënderbeg", Qendra Gurten, Kati 2 Tiranë, Shqipëri.

(c) Çdo ndryshim në Dokumentin e Projektit/Portofolit që do të ndikonte në punën që po kryhet nga Pala Përgjegjëse në përputhje me Shtojcën B (*Përshkrimi i Aktiviteteve*) përfundohet nëpërmjet një ndryshimi në Dokumentin e Projektit/Portofolit nga Palët në Dokumentin e Projektit/Portofolit pas konsultimeve mes UNDP-së dhe Palës Përgjegjëse.



## Të ndryshme

33. Për të gjitha çështjet që nuk mbulohen në mënyrë specifike nën këtë Marrëveshje, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Dokumentin e Projektit/Portofolit apo në versionet e ndryshuara të tij, si dhe dispozitat përkatëse të rregulloreve dhe rregullave financiare të Palës Përgjegjëse dhe UNDP-së.

34. Procedurat e përshkruara në këtë Marrëveshje do të mbeten në fuqi deri në fund të Projektit ose Portofolit (sipas rastit) ose deri në përfundimin e Aktiviteteve apo deri në ndërprerje në përputhje me Nenin 31 (*Pezullimi dhe Ndërprerja*) si më sipër.

35. Gjatë gjithë kohës gjatë kryerjes së Aktiviteteve, kalendari i pagesave i specifikuar në Shtojcën C (*Kalendari i Aktiviteteve, Pajisjeve dhe Pagesave*) mbetet në fuqi, përveç rasteve kur Pala Përgjegjëse udhëzohet ndryshe me shkrim nga UNDP-ja në përputhje me Nenin 32 (*Modifikimet; Njoftimet*) më sipër.

36. Nëse bini dakord me dispozitat e parashikuara më lart, ju lutemi të nënshkruani dy kopje të kësaj Marrëveshjeje dhe t'i dërgoni në këtë zyrë. Pranimi nga ana juaj do të përbëjë bazën për pjesëmarrje në zbatimin e Projektit ose Planin(et) e Punës të Portofolit (sipas rastit).

---

Për dhe në emër të UNDP-së

[Emri]

[Titulli: Përfaqësuese e Përhershme]

[Data]

---

Për dhe në emër të [Qeverisë/ONQ-së]

[Emri]

[Titulli]

[Data]



## [SHTOJCA 1

### KUSHTET E VEÇANTA TË UNDP-së]

Kthim përgjigjeje: Marrëveshja nr. [Vendosni nr. e Marrëveshjes]

Seksionet e mëposhtme të Marrëveshjes janë modifikuar si në vijim<sup>1</sup>:

1. Seksioni [numri] ([Titulli i Seksionit]) zëvendësohet në tërësi me sa vijon:

“ ”

2. Seksionet e reja [numri] dhe [numri] shtohen si më poshtë:

“ ”

\*\*\* Fundi i Kushteve të Veçanta \*\*\*

---

<sup>1</sup> Më poshtë gjeni dy formulime. Teksti aktual që do të përdoret do të varet nga ndryshimet që do të bëhen në Marrëveshje, pra nëse po ndryshoni një klauzolë ekzistuese, përdorni formulimin në paragrafin 1, dhe nëse po shtoni klauzola, përdorni formulimin në paragrafin 2.



**SHTOJCA A**  
**DOKUMENTI I PROJEKTIT/PORTOFOLIT**



## SHTOJCA B

### PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE

Numri i Projektit: 01001859  
Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për SDG-të

Titulli i Projektit/Portofolit: Bashkëpunimi me

Rezultatet që duhet të arrihen nga Bashkia e Himarës

*Jepni një përmbledhje të rezultateve që duhet të arrihen nga Bashkia e Himarës veçanërisht nga produktet, që pritet të prodhojnë.*

Për pilotimin dhe zbatimin e nismës "Olive Heritage Himara", duke promovuar agroturizmin me bazë ullirin, ruajtjen e trashëgimisë së ullirit, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik vendor, rritjen e dukshmërisë së prodhuesve vendas të vajit të ullirit dhe zgjatjen e sezonit turistik në Himarë. Aktivitetet e financuara nga UNDP-ja kontribuojnë në veçanti në rezultatet e mëposhtme të projektit pilot "Olive Heritage Himara":

- Aktivizimi i katër fshatrave (Vuno, Pilur, Dhërmi dhe Himara Qendrore) gjatë periudhës tetor-dhjetor 2026, duke sjellë aktivitet ekonomik dhe kulturor në katër qendra rurale përmes pritjes së vizitorëve, përfshirjes së fermerëve dhe organizimit të ngjarjeve vendase.
- Pjesëmarrja e 40-50 vizitorëve ndërkombëtarë në turin e ullirit, duke përjetuar procesin e vjeljes dhe prodhimit të vajit.
- Përfitim i drejtpërdrejtë për 20 familje vendase, të cilat gjenerojnë të ardhura përmes akomodimit, ushqimit dhe pjesëmarrjes në procesin bujqësor.
- Prodhimi i rreth 500 litrave vaj ulliri artizanal, i përpunuar dhe i pakeluar nën markën "Olive Heritage Himara".
- Promovimi ndërkombëtar i Himarës si destinacion agroturizmi i qëndrueshëm përmes medias, rrjeteve sociale dhe dokumentarit zyrtar

Puna që do të kryhet nga [Bashkia e Himarës]

*Përshkrimi i aktiviteteve që do të kryen nga [Bashkia e Himarës]*

- Koordinimi dhe ofrimi i ekspertizës vendore për të mundësuar zbatimin e projektit.

- Sigurimi i mjeteve dhe materialeve të punës, si mjetet e korrjes, materialet për përdorim në terren dhe uniformat.
- Prodhimi i një dokumentari dhe promovimi i projektit për të siguruar dokumentim të procesit të vjeljes, intervista, të cilat do të shërbejnë si produkt njohurish mbi prodhimin e vajit të ullirit në rajon dhe do të ofrojnë materialet e nevojshme promovuese.
- Organizimi i festivalit për vajin e ri të ullirit. Ky është event i fundit që përmbyll projektin dhe promovon turizmin dhe vajin e ullirit në Himarë.

Përshkrimi i burimeve:

*Jepni një përshkrim të detajuar të burimeve të projektit/portofolit sipas aktivitetit. Këtu mund të përfshihen personeli, kontratat, trajnimet, pajisjet, grantet mikrokapitale dhe të tjera.*

Veprimtaria 1: Prokurimi i pajisjeve dhe materialeve të punës  
Burimet:

- Pajisjet dhe materialet e punës të nevojshme për vjeljen e ullinjve dhe aktivitetet e pjesëmarrjes së vizitorëve;
- Shërbimet e prokurimit;

Veprimtaria 2: Organizimi i festivalit për vajin e ri të ullirit  
Burimet:

- Shërbimet e organizimit të eventeve;
- Vendi, pajisjet dhe marrëveshjet logjistike;
- Personeli i koordinimit dhe ofruesit vendorë të shërbimit.
- Promovimi dhe komunikimi i eventit.

Veprimtaria 3: Angazhimi i ekspertëve vendas  
Burimet:

- Konsulentët dhe ekspertët teknikë vendas;

Veprimtaria 4: Prodhimi i materialeve dokumentuese dhe promovuese  
Burimet:

- Shërbime profesionale fotografie dhe videografie;
- Dizajn grafik, printim dhe materiale promovuese;

Shtojcat:

*Bashkëlidhur, sipas nevojës, një përshkrim pune për konsulentë, terma reference për të kontraktuarit, specifikime teknike për pajisjet, formate të regjistrimit gjatë trajnimeve etj.*



## SHTOJCA C

### KALENDARI I AKTIVITETEVE, MJETEVE DHE PAGESAVE

(PLANI I PUNËS DHE BUXHETI)

Viti 2026

| PRODUKTET<br>E PRITSHME                             | AKTIVITETET E<br>PLANIFIKUARA                                                                                                  | Afati<br>(korrik-dhjetor 2026) |                | Buxheti i planifikuar                                                                                                                                        |         | Plani i Pagesave nga UNDP |                |
|-----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|----------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|---------------------------|----------------|
|                                                     |                                                                                                                                | TREMUJORI<br>3                 | TREMUJORI<br>4 | Përshkrimi i buxhetit                                                                                                                                        | Shuma   | TREMUJORI<br>3            | TREMUJORI<br>4 |
| dhe treguesit,<br>duke përfshirë<br>synimet vjetore | <i>Rendisi të gjitha<br/>aktivitetet që duhen<br/>ndërmarrë gjatë vitit<br/>për arrijen e<br/>rezultateve të<br/>shprehura</i> |                                |                |                                                                                                                                                              |         |                           |                |
| Produkti 2.                                         | 2.1<br>Kordinimi dhe<br>ekspertiza vendore                                                                                     | X                              | X              | Pagesat për një<br>ekspert të bujqësisë,<br>një udhërrëfyes<br>ndërkombëtar, një<br>ekspert të kulturës<br>dhe menaxhimin e<br>përgjithshëm të<br>projektit. | 600.000 | X                         | X              |

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim  
Marrëveshja

|     |                                                                                                      |   |   |                                                                                                     |         |           |           |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|---|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|-----------|-----------|
| 2.2 | Prokurimi i pajisjeve të punës dhe materialeve të nevojshme për zbatimin e aktivitetëve të projektit | X | X | Materiallet dhe pajisjet e punës, të tilla si pajisjet e korjes, etiketat e prodhimit dhe uniformat | 300.000 | X         | X         |
| 2.3 | Prodhim i materialeve dokumentuese dhe promovuese                                                    | X | X | Xhirime profesionale, prodhim videosh dhe publikime promovuese në mediat sociale                    | 500.000 | X         | X         |
| 2.4 | Organizimi i festivalit të vajit të ri të ullirit                                                    | X | X | Organizimi i eventit                                                                                | 600.000 | X         | X         |
|     |                                                                                                      |   |   | Gjithsej                                                                                            |         | 1.000.000 | 1.000.000 |

Kësti 1 - Kësti i parë pas nënshkrimit të kontratës.

Kësti 2 - Pas përdorimit të të paktën 80% të kështit të parë deri më 1 tetor 2026

Shënim:

- Shpenzimet për shërbimet e personelit mund të kufizohen në paga, shpërblime dhe të drejta të tjera, duke përfshirë rimbursimin e tatimit mbi të ardhurat dhe kostot e udhëtimit në rast emërimi në Projekt ose Portofol (sipas rastit), udhëtimet e punës brenda vendit ose rajonit të programit dhe kostot e riatdhesimit.
- UNDP-ja është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të ndryshme, të tilla si asistencë sekretarie, shërbime postare dhe kablllore, si dhe transport, sipas nevojës nga *Bashkia e Himarës* për kryerjen e detyrës së saj.
- Rregullimet brenda secilit prej seksioneve mund të bëhen në konsultime ndërmjet UNDP-së dhe Bashkisë së Himarës. Këto rregullime mund të bëhen nëse ato janë në përputhje me dispozitat e Programit Mbështetës/Dokumentin e Projektit/Portofolit/Programit të Mbështetjes dhe nëse gjykohet se ato janë në interesin më të mirë të Projektit ose Portofolit (sipas rastit).



**SHTOJCA D**  
**FORMULARI I MODELIT TË NËNSHKRIMIT**



FONDACIONI "RRUGA ME PISHA"

## OLIVE HERITAGE HIMARA

*Zgjatja e sezonit turistik përmes kulturës, ullirit dhe bashkëjetesës  
rurale*



PROJEKT PROPOZIM · DOKUMENT APLIKIMI

Projekt pilot · Bashkia Himarë · Fshatrat Vuno, Pilur, Dhërmi & Himarë Qendër

Faza përgatitore: Gusht – Tetor 2026

Zbatimi intensiv në terren: 14 – 30 Nëntor 2026

Raportim & vlerësim: Dhjetor 2026 – Janar 2027

Organizata zbatuese: Fondacioni "Rruga me Pisha"

Bashkëfinancim: Bashkia Himarë & UNDP



Rr. Ismail Qemali, Nr. 11, Tiranë · rrugamepisha@gmail.com · +355 68 200 5355

rrugamepisha.org · Himarë · Shqipëri · 2026



## I. Të dhëna të përgjithshme

Ky dokument paraqet propozimin e plotë të projektit pilot "Olive Heritage Himara". Ai është ndërtuar mbi një plan pune të detajuar (Seksioni VIII), i cili përcakton hap pas hapi fazën përgatitore dhe atë zbatuese, dhe pasurohet me analizën e situatës, modelin e ndërhyrjes, buxhetin, treguesit, qëndrueshmërinë dhe menaxhimin e riskut.

|                                               |                                                                                                                              |
|-----------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Titulli i projektit                           | Olive Heritage Himara — Zgjatja e sezonit turistik përmes kulturës, ullirit dhe bashkëjetesës rurale                         |
| Fusha ku aplikohet                            | Turizëm i qëndrueshëm / agroturizëm dhe trashëgimi kulturore — zhvillim rural                                                |
| Vendi i zbatimit                              | Bashkia Himarë — fshatrat Vuno, Pilur, Dhërmi dhe Himarë Qendër                                                              |
| Prioriteti                                    | Diversifikimi i turizmit dhe zgjatja e sezonit turistik; mbështetja e ekonomisë rurale dhe ruajtja e trashëgimisë së ullirit |
| Kohëzgjatja                                   | Faza përgatitore: Gusht–Tetor 2026<br>Zbatimi intensiv: 14–30 Nëntor 2026<br>Raportim & vlerësim: Dhjetor 2026–Janar 2027    |
| Buxheti total i projektit                     | 5.000.000 Lekë (rreth 50.000 EUR)                                                                                            |
| Buxheti i kërkuar nga Bashkia Himarë          | 3.000.000 Lekë (60%)                                                                                                         |
| Buxheti i siguruar nga bashkëdonatorët (UNDP) | 2.000.000 Lekë (40%)                                                                                                         |
| Organizata zbatuese                           | Fondacioni "Rruga me Pisha"                                                                                                  |
| IBAN                                          | AL05902112090201230006393840                                                                                                 |
| Statusi ligjor                                | Fondacion / organizatë jofitimprurëse (OJF)                                                                                  |
| Numri i regjistrimit                          | Nr. 2608, Vendimi; Akti Nr. 3682, datë 6 Korrik 2001                                                                         |
| Vendi i regjistrimit                          | Gjykata e Rrethit Tiranë, Republika e Shqipërisë                                                                             |
| Data e regjistrimit                           | 6 Korrik 2001 (themeluar nga BBC World Service Trust)                                                                        |
| Adresa                                        | Rr. Ismail Qemali, Nr. 11, Tiranë                                                                                            |
| Drejtues projekti / kontakt                   | Arben Papadhopulli                                                                                                           |
| E-mail dhe telefon                            | rrugamepisha@ymail.com · arben_papadhopulli@yahoo.com · +355 68 200 5355                                                     |

## II. Përmbledhje ekzekutive

“Olive Heritage Himara” është një projekt pilot që e shndërron sezonin tradicional të vjeljes së ullirit në tre fshatra të Himarës — Vuno, Pilur dhe Dhërmi — në një përvojë të gjallë trashëgimie, turizmi të përgjegjshëm dhe vullnetarizmi ndërkombëtar. Në zemër të tij qëndron një ide e thjeshtë dhe e fuqishme: trashëgimia nuk mbrohet vetëm me fjalë, por duke u jetuar.

Nga 14 deri më 30 Nëntor 2026, një grup prej 50 vizitorësh-vullnetarë vendas dhe të huaj nga Evropa vjen e strehohet pranë familjeve fermere, mëson artin e vjeljes degë pas dege, prodhon vajin në fabrikat e Himarës dhe e mbyll përvojën me “Festën e Ullirit të Ri” më 30 Nëntor. Në shenjë mirënjohjeje, çdo pjesëmarrës merr 20–25% të vajit të prodhuar gjatë qëndrimit, të pakeluar nën markën lokale “Olive Heritage Himara” — një kujtim i gjallë dhe një ambasador i vogël i produktit vendas.

Projekti bashkon në një zinxhir të vetëm bujqësinë tradicionale, trashëgiminë kulturore dhe mikpritjen vendase. Ai ndihmon fermerët me fuqi punëtore pikërisht kur u nevojitet më shumë, gjeneron të ardhura për familjet pritëse pas mbylljes së sezonit veror, fuqizon gratë e të rinjtë, zgjat sezonin turistik në vjeshtë dhe ruan ullishtat shekullore që përndryshe rrezikojnë braktisjen.

Me një buxhet total prej 5.000.000 Lekë, të bashkëfinancuar nga Bashkia Himarë (60%) dhe UNDP (40%), rreth 80% e fondeve shkojnë drejtpërdrejt te komuniteti lokal. Modeli është i replikueshëm çdo vit dhe i zgjerueshëm në fshatra të tjera, duke e pozicionuar Himarën në hartën e turizmit të qëndrueshëm mesdhetar.

### Projekti shkurtimisht.

|                                                           |                                                            |                                               |
|-----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| <b>≈ 50</b><br>vizitorë-vullnetarë ndërkombëtarë e vendas | <b>3+1</b><br>fshatra: Vuno, Pilur, Dhërmi & Himarë Qendër | <b>30</b><br>familje pritëse të përfshira     |
| <b>≈ 40</b><br>fermerë të mbështetur                      | <b>≈ 2000 L</b><br>vaj ulliri artizanal i prodhuar         | <b>≈ 80%</b><br>e fondeve mbeten në komunitet |

### III. Analiza e situatës

---

Himara është një nga zonat me potencialin më të madh turistik dhe agrobujqësor në rivierën shqiptare. E shtrirë midis Maleve të Vetëtimës (Akrokeraune) dhe bregdetit jonian, me klimë mesdhetare, fshatra historikë, ullishta shekullore dhe një trashëgimi të pasur kulturore, ajo ka gjithçka për t'u bërë destinacion i një turizmi cilësor gjithëvjetor. Megjithatë, aktiviteti ekonomik i zonës mbetet pothuajse tërësisht i përqendruar në tre-katër muajt e verës, kur fluksi i pushuesve mbush plazhet. Ky model i njëanshëm e bën ekonominë lokale të brishtë, sezonale dhe të varur nga një periudhë e shkurtër.

Pas mbylljes së sezonit veror, fshatrat malorë si Vuno, Pilur dhe Dhërmi hyjnë në një periudhë qetësie të thellë ekonomike: shumica e bizneseve turistike mbyllen, punësimi sezonal ndërpritet dhe një pjesë e konsiderueshme e të rinjve largohen drejt qyteteve ose emigrojnë. Komuniteti rural mbetet pa burime të qëndrueshme të ardhurash gjatë gjithë vjeshtës e dimrit, ndërkohë që shtëpitë tradicionale, njohuritë dhe kultura e mikpritjes rrezikojnë të mbeten të pashfrytëzuara.

Pikërisht në këtë periudhë — nga vjeshta deri në fillim të dimrit — zhvillohet vjelja e ullirit, një nga aktivitetet më të rëndësishme ekonomike dhe identitare të Himarës. Por shumë fermerë, veçanërisht të moshuarit, përballen çdo vit me vështirësi serioze për ta përfunduar në kohë vjeljen, për shkak të mungesës së fuqisë punëtore dhe largimit të brezit të ri. Si pasojë, një pjesë e ullishtave lihen pa u vjelur, prodhimi bie, cilësia e vajit ulet dhe disa ullishta të vjetra rrezikojnë braktisjen e plotë — duke kërcënuar një trashëgimi shekullore dhe një burim jetik të ardhurash.

Ulliri në Himarë nuk është thjesht një produkt bujqësor; ai është simbol identiteti, bashkëjetese dhe kujtese kolektive. Rreth tij janë ndërtuar mënyra e jetesës, kuzhina, mjekësia popullore, traditat familjare dhe marrëdhënia harmonike mes njeriut e natyrës. Çdo ullishte mbart histori brezash, çdo pemë ka emër e kujtim, dhe vaji ka qenë gjithmonë në qendër të tryezës e të jetës shoqërore. Humbja e këtij cikli do të thotë humbje e një pjese të identitetit kulturor të zonës.

Njëkohësisht, tregu ndërkombëtar i udhëtimeve po orientohet gjithnjë e më shumë drejt segmenteve “slow tourism” dhe “experience travel” — udhëtarë që nuk kërkojnë thjesht plazh e pushim, por përvoja autentike, kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin dhe pjesëmarrje konkrete në jetën rurale. Ky segment është në rritje të qëndrueshme, ka fuqi blerëse mbi mesataren dhe udhëton pikërisht jashtë sezonit të pikut. Himara i ka të gjithë elementët për ta thithur këtë treg — peizazhin, gastronominë, mikpritjen dhe kulturën e ullirit — por ky potencial mbetet i pashfrytëzuar dhe i palidhur me ekonominë e fshatrave.

“Olive Heritage Himara” lind si përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj këtyre sfidave të ndërlidhura. Projekti e shndërron vjeljen e ullirit në një përvojë turistike autentike që, në të njëjtën kohë, ndihmon fermerët me fuqi punëtore, gjeneron të ardhura për familjet pritëse, përfshin gratë e të rinjtë, zgjat sezonin turistik dhe ruan trashëgiminë rurale — duke e kthyer ullirin nga një barrë e vështirë në një burim krenarie, ekonomie dhe identiteti.

#### IV. Arsyetimi dhe rëndësia e projektit

---

Projekti adreson njëkohësisht disa sfida kritike e të ndërlidhura të zonës: rënien e thellë të aktivitetit ekonomik pas sezonit veror, mungesën e fuqisë punëtore për vjeljen e ullirit, braktisjen graduale të ullishtave tradicionale dhe largimin e të rinjve. Duke e lidhur turizmin përjetues drejtpërdrejt me ciklin bujqësor të ullirit, “Olive Heritage Himara” ndërton një zgjidhje të integruar ku çdo aktor jep një kontribut dhe merr një përfitim konkret.

Rëndësia e projektit qëndron në karakterin e tij si model. Ai është një laborator i vogël inovacioni social dhe ekonomik: një ekosistem bashkëpunimi me vlerë të shtuar për të gjithë — fermerët ruajnë traditën, vizitorët përjetojnë autenticitetin, familjet gjenerojnë të ardhura, fondacioni rrit kapacitetet e veta dhe bashkia përfiton një model të suksesshëm zhvillimi rural. Vizitori nuk është konsumator pasiv, por pjesë aktive e jetës rurale: ai krijon të ardhura të drejtpërdrejta, forcon lidhjet ndërbrezore, zgjeron sezonin turistik dhe ndihmon në ruajtjen e trashëgimisë.

Ky model është i replikueshëm në zona të tjera rurale të Shqipërisë dhe të rajonit, duke kontribuar në politikat kombëtare për agroturizmin dhe zhvillimin rural. Mbështetja institucionale e Bashkisë Himarë dhe bashkëfinancimi nga UNDP i japin projektit qëndrueshmëri, besueshmëri dhe një kuadër zhvillimor afatgjatë, duke e kthyer ullirin në një urë mes së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes.

## V. Objektivi i përgjithshëm dhe objektivat specifike

---

### Objektivi i përgjithshëm

Të zhvillojë një formë të re të turizmit gjithëvjeter dhe të qëndrueshëm në krahinën e Himarës, duke bashkuar bujqësinë tradicionale, trashëgiminë kulturore dhe mikpritjen vendase në një përvojë të vetme e të plotë për vizitorin. Projekti synon ta transformojë potencialin e ullirit — si produkt, si peizazh dhe si simbol i jetës rurale — në një shtyllë zhvillimi ekonomik dhe identitar për komunitetet vendase, duke e pozicionuar Himarën si destinacion i turizmit përjetues mesdhetar.

### Objektivat specifike

1. Të zhvillohet një model pilot i turizmit të ullirit me pjesëmarrje ndërkombëtare. Modeli pilotohet për herë të parë në Vuno, Pilur dhe Dhërmi, duke ofruar një përvojë të plotë nga vjelja te shtrydhja dhe paketimi i vajit, dhe duke testuar mekanizma të vetëqëndrueshëm ekonomikë të përsëritshëm çdo vit.
2. Të ndihmohen fermerët lokalë në vjeljen dhe përpunimin e ullirit. Nëpërmjet mobilizimit të grupeve të vizitorëve-vullnetarë, turizmi kthehet në burim konkret të fuqisë punëtore sezonale, duke rritur sasinë e prodhimit, përmirësuar cilësinë e vajit dhe shtuar të ardhurat e fermerëve.
3. Të krijohen të ardhura shtesë për familjet rurale përmes akomodimit dhe ushqimit. Mikpritja e vizitorëve në shtëpi tradicionale dhe përgatitja e vakteve lokale gjenerojnë të ardhura pas sezonit veror, fuqizojnë gratë e të rinjtë dhe nxisin ruajtjen e kulinarisë tradicionale.
4. Të dokumentohet dhe promovohet trashëgimia e ullirit dhe gastronomisë mesdhetare. Përmes fotografisë, videove, intervistave dhe botimeve ndërtohet një arkiv kulturor i ullirit në Himarë, si bazë për promovim turistik e edukativ dhe ruajtje të kujtesës kolektive.
5. Të organizohet event i përmbyllës kulturor "Festa e Ullirit të Ri". Një ngjarje publike që bashkon komunitetin, vizitorët, prodhuesit dhe artizanët, shërben si platformë promovimi dhe ngjarje identitare për Himarën, me synim institucionalizimin si aktivitet i përvitshëm.

## VI. Grupet e synuara dhe përfituesit

---

Projekti është ndërtuar që përfitimet të shpërndahen gjerësisht në komunitet, duke prekur drejtpërdrejt familjet, fermerët dhe ofruesit e shërbimeve, dhe tërthorazi të gjithë ekonominë lokale e institucionale.

### Përfituesit e drejtpërdrejtë

- **Familjet pritëse (rreth 50):** gjenerojnë të ardhura nga akomodimi dhe ushqimi dhe rivlerësojnë shtëpitë e vjetra e kulinarinë tradicionale.
- **Fermerët (rreth 30):** veçanërisht të moshuarit, përfitojnë ndihmë konkrete në vjelje e transport, rritje të prodhimit dhe cilësisë së vajit.
- **Përpunuesit e vajit, shoferët dhe ndihmësit logjistikë:** përfitojnë rritje të volumit të punës, ekspozim turistik dhe punësim sezonal.
- **Gratë dhe të rinjtë e zonës:** përfshihen si mikpritëse, guida, përkthyes dhe ndihmës, duke u fuqizuar ekonomikisht e socialisht.
- **50 vizitorë-vullnetarë ndërkombëtarë e vendas:** përjetojnë dhe promovojnë eksperiencën, duke u bërë ambasadorë të Himarës.

### Përfituesit e tërthortë

- Komuniteti i gjerë i fshatrave Vuno, Pilur, Dhërmi dhe qendra e Himarës, përmes aktivizimit ekonomik e kulturor.
- Bashkia Himarë: aktivizim i ekonomisë rurale, rritje e punësimit sezonal dhe forcim i imazhit si destinacion gjithëvjeter.
- Sektori i agroturizmit dhe turizmit rural në rivierën shqiptare e më gjerë, që fiton një model reference.
- Tregu vendas dhe kombëtar i vajit, përmes markës “Olive Heritage Himara” si vaj artizanal me origjinë gjeografike.

## VII. Modeli i ndërhyrjes dhe struktura e përvojës

Gjatë periudhës 14–30 Nëntor 2026, projekti organizon një cikël intensiv me një grup të vetëm prej 30–50 vizitorësh-vullnetarë. Ata ftohen të jetojnë për rreth dy javë pranë familjeve pritëse në Vuno, Pilur dhe Dhërmi, duke marrë pjesë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të komunitetit dhe në të gjitha fazat e ciklit të ullirit — nga vjelja dhe pastrimi i ullishtave, te transporti, shtrydhja, paketimi dhe degustimi i vajit. Në këmbim të kontributit të tyre, pjesëmarrësit përfitojnë 20–25% të vajit të prodhuar gjatë qëndrimit, të paketuuar nën markën “Olive Heritage Himara”.

### Grupi i synuar

Programi synon udhëtarë evropianë të profilin të mesëm dhe të lartë, të moshave 25–50 vjeç, kryesisht individë ose çifte nga Italia, Gjermania, Franca, Polonia dhe vendet skandinave, me interes për agroturizëm, gastronomi mesdhetare, ruajtje të traditës dhe jetesë të qëndrueshme, si dhe vullnetarë vendas nga i gjithë vendi. Ata përfaqësojnë segmentin në rritje të “slow tourism” dhe “experience travel”, ku udhëtimi shihet jo vetëm si pushim, por si mënyrë për të mësuar, për të ndihmuar dhe për të ndarë me komunitetet lokale.

### Parimet e organizimit

- **Grup i vetëm intensiv** prej 50 pjesëmarrësish, i ndarë në disa ekipe pune që rrotullohen nëpër ullishtat e tre fshatrave.
- **Kohëzgjatja** 17 ditë (14–30 Nëntor), e ndërtuar për të kombinuar punën me relaksin, mësimin me përjetimin dhe përvojën individuale me jetën komunitare.
- **Mbështetja** e çdo ekipi sigurohet nga një koordinator lokal (guidë) dhe një përkthyes kulturor, që garantojnë komunikim, orientim dhe ndihmë praktike gjatë gjithë qëndrimit.
- **Shpërblimi** simbolik: 20–25% e vajit të prodhuar i jepet secilit pjesëmarrës, i paketuuar në shishe të personalizuar nën markën lokale.

### Mikpritja në shtëpi dhe jeta komunitare

Akomodimi realizohet në shtëpi tradicionale të rikonstruara, me standarde komode por me atmosferë autentike; çdo familje pret 1–2 vizitorë. Kjo formë mikpritjeje është thelbi social i projektit: vizitori nuk qëndron në hotel, por bëhet përkohësisht “bashkëfshatar”, ndan tryezën, kuzhinën dhe ritmin e ditës me familjen pritëse. Familjet ofrojnë tre vakte ditore me produkte të zonës dhe i ftojnë vizitorët të marrin pjesë në gatimin e recetave tipike himarjote — nga vaji i ri, te byrekët, perimet e stinës, djathi dhe ëmbëlsirat tradicionale.

Programi pasurohet me aktivitete kulturore: vizita në monumente fetare e kulturore (Kisha e Shën Mërisë në Dhërmi, Manastiri i Shën Theodhorit në Vuno), shëtitje në shtigjet panoramike të ullishtave dhe mbrëmje me tregime e muzikë lokale. Përfshihen edhe elemente edukative mbi bujqësinë organike, ruajtjen e tokës dhe ekonominë rrethore, si dhe një gjest simbolik — mbjellja e një ulliri nga secili ekip, si “kujtesë e përbashkët” e eksperiencës.

[illegible][illegible]

| Java         | Detyrat kryesore                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Përgj.  | Produkti                                                |
|--------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|---------------------------------------------------------|
| Java 4 22–31 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lançimi i fushatës së ndërmjetësimit për vizitorë-vullnetarë (vendas + Evropë) në rrjete sociale dhe platforma vullnetarizmi.</li> <li>• Kontakti i parë zyrtar me agjencitë turistike, organizatat e vullnetarëve, UNDP dhe agjencitë e BE-së.</li> </ul> | EK • KP | Fushata online aktive; kontaktet me partnerë të hapura. |

#### Shtator 2026 *Objekti: ekipi operacional, kontratat & harta e ullishtave*

| Java         | Detyrat kryesore                                                                                                                                                                                                                                                        | Përgj.  | Produkti                                     |
|--------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|----------------------------------------------|
| Java 1 01–07 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Publikimi i thirrjeve për koordinatorë lokalë, trajnues dhe ekupe mbështetëse.</li> <li>• Pritja e aplikimeve dhe intervistat e para.</li> </ul>                                                                               | KP      | Kandidatët e përzgjedhur.                    |
| Java 2 08–14 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontraktimi i koordinatorëve lokalë (një për fshat), trajnuesve dhe ekupeve.</li> <li>• Përcaktimi i roleve dhe orareve.</li> </ul>                                                                                            | KP      | Ekipi i kontraktuar dhe i orientuar.         |
| Java 3 15–21 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me fabrikat e vajit të Himarës: orari, kapaciteti, radha, çmimi i bluarjes.</li> <li>• Sigurimi i veglave: shkopinj, krehër, rrjeta, kova, thasë, doreza, shkallë, peshore.</li> </ul> | KP • EL | Marrëveshjet me fabrikat; veglat e siguruar. |
| Java 4 22–30 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i hartës së ullishtave sipas pronarit (skicë/GPS për parcelë).</li> <li>• Organizimi paraprak i planit të punës për çdo fshat e familje.</li> <li>• Vlerësimi i qasjes, largësive dhe rendit të vjeljes.</li> </ul>    | KL      | Harta e ullishtave; plani paraprak i punës.  |


#### Tetor 2026 *Objekti: logjistika, guida turistike & agjenda e festës*

| Java         | Detyrat kryesore                                                                                                                                                                                                                                                 | Përgj.  | Produkti                                        |
|--------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|-------------------------------------------------|
| Java 1 01–07 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Takime me specialistët e turizmit të Bashkisë Himarë dhe DRTK Vlorë.</li> <li>• Përgatitja e guidës turistike për vizitorët: pika interesi, itinerare, tradita, kulinari.</li> </ul>                                    | KP      | Guida turistike e hartuar.                      |
| Java 2 08–14 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Marrëveshjet me bujtinat dhe restorantet e vogla për ushqimin në tre fshatrat.</li> <li>• Caktimi i menisë, kapaciteteve dhe orareve të vakteve.</li> </ul>                                                             | EL      | Ushqimi i siguruar për të tri fshatrat.         |
| Java 3 15–21 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfirmimi përfundimtar i vizitorëve dhe caktimi i akomodimit pranë familjeve.</li> <li>• Plani i transportit, mbërritjeve dhe largimeve; sigurimi shëndetësor.</li> </ul>                                              | EK • EL | Lista përfundimtare; plani i akomodimit.        |
| Java 4 22–31 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ideimi dhe nisja e fushatës ndërgjegjëse në tre fshatrat.</li> <li>• Ndërtimi i agjendës së plotë të "Festës së Ullirit të Ri".</li> <li>• Prova logjistike: çadra e ngrohur, skena, stendat, juria, çmimet.</li> </ul> | EK • KP | Fushata e nisur; agjenda e festës e finalizuar. |


### 8.2 Faza B — Zbatuese (14 – 30 Nëntor 2026)

Zbatimi shtrihet për shtatëmbëdhjetë ditë, nga mbërritja e vizitorëve deri te festa. Grafikët e mëposhtëm tregojnë ecurinë ditore dhe peshën e secilit aktivitet.

## Kalendari ditor i zbatimit - 14-30 Nëntor 2026



### Shpërndarja e ditëve sipas aktivitetit



### Mbërritja & njohja — 14-15 Nëntor (E shtunë – E diel)

| Data             | Periudha         | Aktiviteti                                                                                                                    | Produkti                                            |
|------------------|------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| 14 Nën. E shtunë | Paradite–Pasdite | Mbërritja e vizitorëve në Himarë; pritja, akomodimi pranë familjeve, dorëzimi i pakos së mirëseardhjes (guida, harta, orari). | Vizitorët e strehuar; secili di familjen e fshatin. |
| 14 Nën.          | Mbrëmje          | Darkë njohjeje me familjet mikpritëse; prezantim i shkurtër i projektit dhe rregullave të sigurisë.                           | Fillimi i lidhjes vizitor–familje.                  |
| 15 Nën. E diel   | Paradite         | Takim i përbashkët: diskutimi i planeve të punës, njohja me ekipet lokale dhe koordinatorët, shpërndarja në tre ekipe.        | Ekipet e formuara; plani i kuptuar.                 |
| 15 Nën.          | Pasdite          | Guidë hyrëse: njohja me ullishtat, shtigjet, pikat e mbledhjes dhe fabrikën e vajit.                                          | Vizitorët njohin terrenin e punës.                  |

### Trajinimi i dedikuar — 16 Nëntor (E hënë)

| Ora         | Aktiviteti                                                                                                                                                | Produkti                                     |
|-------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
| 08:30–10:30 | Teori: Llojet e ullirit, njohja me rrënjët dhe pemët, koha e duhur e vjeljes, cilësia e kokrrës dhe lidhja mes pjekurisë, aciditetit e cilësisë së vajit. | Vizitorët kuptojnë bazat e vjeljes cilësore. |
| 10:30–12:30 | Praktikë: përdorimi i saktë i veglave (shkopinj, krehër, rrjeta), teknika e vjeljes pa dëmtuar degët, siguria në terren dhe në shkallë.                   | Teknika e vjeljes e ushtruar në terren.      |
| 13:30–15:30 | Plani i punës për secilin fermer: caktimi i ullishteve, rendi i vjeljes, objektivat ditorë dhe sistemi i regjistrimit sipas familjes.                     | Çdo ekip di ullishtat dhe objektivat.        |
| 15:30–16:30 | Shpërndarja e veglave dhe pajisjeve të sigurisë; kontrolli i gatishmërisë.                                                                                | Ekipet plotësisht të pajisura.               |

### Vjelja e ullirit — 17-23 Nëntor *(shtatë ditë pune në terren)*

Vjelja është aktiviteti qendror. Puna organizohet në tre ekipe të përziera (vizitorë + familje) që rrotullohen nëpër ullishtat e Vunos, Pilurit dhe Dhërmiut, në mënyrë që ngarkesa të shpërndahet dhe të gjitha parcelat të mbulohen brenda javës.

#### Ritmi ditor i vjeljes

- 07:30 — Mëngjes te familjet pritëse.
- 08:00–08:30 — Nisja për në ullishte dhe shpërndarja e veglave.
- 08:30–12:30 — Vjelje (shkopinj, krehër, rrjeta nën pemë).
- 12:30–13:30 — Drekë në terren ose te bujtina.
- 13:30–16:30 — Vjelje, mbushja dhe etiketimi i thasëve sipas familjes.
- 16:30–17:00 — Peshimi, regjistrimi ditor dhe transporti i thasëve.
- Mbrëmje — pushim dhe jetë komunitare me familjet.

#### Rotacioni i ekipeve nëpër fshatra

| Dita           | Ekipi A                      | Ekipi B                      | Ekipi C                      |
|----------------|------------------------------|------------------------------|------------------------------|
| 17 Nën. (Mar.) | Vuno — zona veriore          | Pilur — zona qendrore        | Dhërmi — zona bregore        |
| 18 Nën. (Mër.) | Vuno — zona veriore          | Pilur — zona lindore         | Dhërmi — zona bregore        |
| 19 Nën. (Enj.) | Pilur — zona qendrore        | Dhërmi — zona kodrinore      | Vuno — zona jugore           |
| 20 Nën. (Pre.) | Pilur — zona lindore         | Dhërmi — zona kodrinore      | Vuno — zona jugore           |
| 21 Nën. (Sht.) | Dhërmi — zona bregore        | Vuno — zona veriore          | Pilur — zona qendrore        |
| 22 Nën. (Die.) | Dhërmi — zona kodrinore      | Vuno — zona jugore           | Pilur — zona lindore         |
| 23 Nën. (Hën.) | Rezervë / parcelat e mbetura | Rezervë / parcelat e mbetura | Rezervë / parcelat e mbetura |

Shënim: zonat brenda çdo fshati janë indikative dhe përcaktohen përfundimisht sipas hartës së ullishtave dhe pronarëve.

#### Prodhimi i vajit — 24-26 Nëntor *(E martë – E enjte)*

| Data    | Aktiviteti                                                                                                                            | Produkti                                     |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
| 24 Nën. | Transporti i ullinjve në fabrikat e vajit të Himarës sipas radhës; larja, ndarja dhe pesha para bluarjes; regjistrimi sipas familjes. | Ullinj të në fabrikë; sasitë e regjistruara. |
| 25 Nën. | Bluarja dhe nxjerrja e vajit; vizitorët ndjekin procesin nga kokrra të vaji i freskët; matja e rendimentit për familje.               | Vaji i prodhuar; rendimenti i matur.         |
| 26 Nën. | Përfundimi i bluarjes; dekantimi dhe ruajtja e vajit; ndarja e sasive sipas pronarit dhe rezervimi i 20–25% për vizitorët.            | Vaji i prodhuar e i ruajtur sipas familjes.  |

#### Paketim, markim & kulturë — 27-29 Nëntor *(Ditë e festave kombëtare)*

| Data                    | Aktiviteti                                                                                                                                               | Produkti                                          |
|-------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| 27 Nën. E premte        | Paketimi i vajit në shishe; krijimi i broshurave me emrin dhe historinë e familjes ku janë mbledhur ullinj të; përgatitja e etiketave nën markën lokale. | Vaji i paketuar e i markuar; broshurat familjare. |
| 28 Nën. Dita e Flamurit | Ndërtimi i stendave për produktin e çdo familjeje/ekipi; guidë turistike në krahinën e Himarës; njohja me traditën dhe kulturën.                         | Stendat gati; vizitorët njohin krahinën.          |

| Data                    | Aktiviteti                                                                                                                  | Produkti                       |
|-------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|
| 29 Nën. Dita e Çlirimit | Workshop gatimi tradicional me familjet; provë degustimi dhe përgatitja finale për festën; kontroll i fundit i logjistikës. | Gatishmëri e plotë për festën. |

#### **Festa e Ullirit të Ri — 30 Nëntor** *(E hënë · dita kulmore — shih Seksionin IX)*

Dita e fundit i kushtohet festës publike në Himarë Qendër, ku prezantohet vaji i ri, degustohet, vlerësohet nga një juri dhe shpërblehet me çmime e certifikata. Programi i detajuar orë pas ore dhe lista e çmimeve jepen në Seksionin IX.

### **8.3 Faza raportuese (Dhjetor 2026 – Janar 2027)**

Pas festës, ekipi përgatit raportin teknik e financiar, vlerëson ndikimin sipas treguesve, dokumenton mësimet e nxjerra dhe harton planin e Fazës II me zgjerimin gjeografik. Kjo fazë siguron transparencën ndaj Bashkisë Himarë dhe UNDP-së dhe përgatit përsëritjen e nismës vitin e ardhshëm.

### **8.4 Piketat kryesore**

| Afati           | Piketa / Produkti                                                                      | Faza     |
|-----------------|----------------------------------------------------------------------------------------|----------|
| 31 Gusht 2026   | Komuniteti i angazhuar, pëlqimet e nënshkruara dhe fushata e vullnetarëve aktive.      | Piketa 1 |
| 30 Shtator 2026 | Ekipi i kontraktuar, marrëveshjet me fabrikat dhe harta e ullishtave gati.             | Piketa 2 |
| 31 Tetor 2026   | Guida, ushqimi, akomodimi dhe agjenda e festës të finalizuara; vizitorët e konfirmuar. | Piketa 3 |
| 16 Nëntor 2026  | Vizitorët e mbërritur, të trajnuar dhe të pajisur; ekipet gati.                        | Piketa 4 |
| 23 Nëntor 2026  | Vjelja e përfunduar në tre fshatrat; sasitë e regjistruara sipas familjes.             | Piketa 5 |
| 26 Nëntor 2026  | I gjithë vaji i prodhuar, i matur dhe i ruajtur sipas pronarit.                        | Piketa 6 |
| 30 Nëntor 2026  | Festa e Ullirit të Ri e realizuar; çmimet e ndara; projekti i promovuar.               | Piketa 7 |
| 31 Janar 2027   | Raporti teknik e financiar dhe plani i Fazës II të dorëzuar.                           | Piketa 8 |

## IX. Festa e Ullirit të Ri

“Festa e Ullirit të Ri” është ngjarja përmbyllëse dhe kulmore e projektit. Ajo zhvillohet më 30 Nëntor 2026 në Himarë Qendër dhe ekspozon gjithçka të arritur: punën e përbashkët të fermerëve, pjesëmarrjen e vizitorëve, mikpritjen e familjeve dhe rigjallërimin e traditës. Festa nuk është thjesht një ceremoni mbyllëse, por një moment komunitar e identitar, që synon të kthehet në ngjarje të përvitshme dhe në markë kulturore të Bashkisë Himarë.

Meqë festa mbahet në fund të nëntorit, kur moti mund të jetë i ftohtë e me shi, ajo organizohet nën një çadër të madhe të mbyllur dhe të ngrohur (ose në një mjedis të mbyllur si sallë komunitare), me mundësi shtrirjeje në natyrë nëse moti e lejon. Çdo ekip pune vendos stendën dhe shishet e veta për degustim; një juri e pavarur vlerëson vajin; në fund ndahen çmimet dhe certifikatat.

### Komponentët e festës

- **Panairi & degustimi:** prezantim i vajrave të rinj nën markën “Olive Heritage Himara”, shoqëruar me bukë, djathë, ullinj dhe verë lokale; stenda artizanale me mjaltë, reçel, sapun me vaj ulliri, raki e punime dore; demonstrime të shtypjes së ullirit.
- **Ekspozita & dokumentari:** ekspozitë me fotografi artistike nga periudha e projektit; prezantim publik i dokumentarit “Olive Heritage Himara — Nga ulliri tek përvoja”; panel diskutimi me fermerë, vizitorë, Bashkinë dhe media.
- **Muzika & vallet:** muzikë popullore labërisht-himarjote, iso-polifonia e jugut, valle tradicionale nga grupe rinore dhe performanca të fëmijëve me këngë e poezi për ullirin.
- **Ceremonia e çmimeve:** shpallja e fituesve dhe ndarja e certifikatave, si moment kulmor i ditës.

### Programi orientues i ditës

| Ora         | Aktiviteti                                                                                                                               |
|-------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 09:00–10:30 | Ngritja e stendave nën çadrën e ngrohur; përgatitja e stacioneve të degustimit; pritja e vizitorëve me çaj mali dhe ullinj të freskët.   |
| 10:30–11:00 | Ceremonia e hapjes: fjalë përshëndetëse nga komuniteti, Bashkia Himarë dhe partnerët; hapja simbolike e shishes së parë të vajit të ri.  |
| 11:00–13:00 | Degustimi publik ndër stendat e ekipeve; juria fillon vlerësimin sipas shijes, aromës dhe cilësisë; program folklorik dhe iso-polifonia. |
| 13:00–15:00 | Dreka komunitare me kuzhinën tradicionale të Himarës; tregu i produkteve vendase dhe artizanatit.                                        |
| 15:00–16:30 | Program kulturor: valle, këngë, aktivitete për fëmijë; juria përfundon vlerësimin dhe mbledhen votat e publikut.                         |
| 16:30–18:00 | Ceremonia e çmimeve: shpallja e fituesve dhe ndarja e certifikatave; foto e madhe e përbashkët.                                          |
| 18:00–...   | Mbrëmja përmbyllëse me muzikë e valle; ndarje mes vizitorëve dhe familjeve mikpritëse.                                                   |

### Çmimet dhe certifikatat

Për të nderuar punën e të gjithëve dhe për të krijuar traditë, festa ndan një sërë çmimesh e certifikatash. Fituesit përzgjidhen nga juria, nga komuniteti dhe nga vota e publikut.

| Çmimi / Certifikata                  | Përshkrimi                                                                           |
|--------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|
| “Ari i Himarës” — Vaji më i shijshëm | Çmimi kryesor për vajin që vlerësohet më lart nga juria për shije, aromë dhe cilësi. |
| Ekipi më i mirë i vjeljes            | Për ekipin që dallohet për punë, organizim dhe frymë bashkëpunimi.                   |
| Familja mikpritëse më e mirë         | Për familjen që ofron mikpritjen dhe përvojën më të bukur për vizitorët.             |
| Koordinatori lokal më i mirë         | Për koordinatoren që menaxhon më mirë ekipet, logjistikën dhe komunikimin.           |
| Mjeshtri / trajnuesi më i mirë       | Për trajnuesin që përcjell më mirë njohuritë tradicionale.                           |

| Çmimi / Certifikata                          | Përshkrimi                                                                      |
|----------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|
| Vizitori më frymëzues                        | Për pjesëmarrësin që lë gjurmën më të mirë me përkushtim dhe shpirt ekipi.      |
| "Ulliri Patriark"                            | Çmim simbolik për pemën më të vjetër të ullirit të regjistruar gjatë projektit. |
| Prodhimtaria më e lartë                      | Për familjen/ullishten me rendimentin më të mirë të vajit.                      |
| Stenda më e bukur                            | Për prezantimin dhe dizajnin më tërheqës të produktit.                          |
| Rrëfimi familjar më i bukur                  | Për broshurën me historinë më prekëse të familjes.                              |
| Çmimi i publikut                             | Vaji ose stenda e preferuar nga vizitorët, sipas votës së publikut.             |
| "Ura Evropiane" — Fryma e vëllazërimit       | Për vizitorin e huaj/të diasporës që ndërton më mirë urën mes kulturave.        |
| Çmimi i qëndrueshmërisë                      | Për praktikën më miqësore me mjedisin gjatë vjeljes dhe prodhimit.              |
| Certifikata "Ambasador i Ullirit të Himarës" | Certifikatë pjesëmarrjeje për çdo vizitor, si njohje e kontributit.             |
| Certifikata mirënjohjeje për partnerët       | Për institucionet, agjencitë dhe bizneset mbështetëse.                          |

Promovimi bëhet përmes faqeve zyrtare të bashkisë, rrjeteve sociale, mediave kombëtare dhe rrjeteve të turizmit rajonal. Pjesëmarrja pritët të përfshijë rreth 300–500 vizitorë, dhe eventi synohet të futet zyrtarisht në Kalendarin Kulturor Vjetor të Bashkisë Himarë.

## X. Aktorët dhe rolet e tyre

Zbatimi mbështetet mbi një strukturë bashkëpunimi mes pesë aktorëve kryesorë, që ndërveprojnë drejtpërdrejt dhe krijojnë një zinxhir të integruar prodhimi, mikpritjeje dhe përvoja — modeli “nga rrënjët tek përvoja”, ku secili kontribuon me burimet e veta dhe merr një përfitim konkret.

| Aktori                      | Kontributi                                                                                                                                    | Përfitimet                                                                                                                        |
|-----------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Fermerët lokalë             | Vënë në dispozicion ullishtat; ndajnë njohuritë mbi vjeljen e përpunimin; drejtojnë proceset praktike dhe orientojnë ekipet.                  | Ndihmë fizike në periudhën më të ngarkuar; rritje e sasisë e cilësisë; kursim kohe; forcim i lidhjeve komunitare.                 |
| Vizitorët-vullnetarë        | Bashkë-prodhues të eksperiencës: vjelin, pastrojnë, transportojnë e përpunojnë; kontribuojnë financiarisht për akomodim, ushqim e logjistikë. | 20–25% e vajit nën markën lokale; përvojë autentike; ndërveprim me komunitetin; kujtesë e krijuar me duart e tyre.                |
| Familjet pritëse            | Ofrojnë akomodim dhe ushqim tradicional; përcjellin zakonet e kuzhinën; përfshijnë gratë e të rinjtë në mikpritje.                            | Të ardhura të drejtpërdrejta; rikthim vëmendjeje ndaj shtëpive të vjetra; fuqizim ekonomik familjar.                              |
| Fondacioni “Rruga me Pisha” | Koordinator i përgjithshëm: organizim logjistik, trajnim, komunikim publik dhe dokumentim; garanton cilësinë dhe matjen e impaktit.           | Forcimi i profilit si aktor zhvillimor; modeli i replikueshëm; rritje e vizibilitetit institucional.                              |
| Bashkia Himarë              | Partner institucional dhe donator kryesor: mbështetje financiare e logjistike, infrastrukturë, asistencë administrative dhe promovim zyrtar.  | Aktivizim i ekonomisë rurale; rritje e punësimit sezonal; forcim i imazhit si bashki e orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm. |

### Struktura organizative

- **Koordinatori i projektit (Fondacioni):** harton e zbaton planin operacional e buxhetor, koordinon aktorët, mbikëqyr trajnimet e standardet, dokumenton dhe raporton.
- **Mbështetës institucional (Bashkia Himarë):** integron projektin në politikat lokale, ofron asistencë financiare e logjistike dhe mbështet festën.
- **Eksperti agrar / turizëm rural:** planifikon vjeljen me fermerët e ekipet, siguron pajisjet e standardet e sigurisë dhe bashkëpunon me përpunuesit.
- **Eksperti i kulturës dhe trashëgimisë:** dokumenton traditat, përgatit materialet kulturore dhe organizon eventet artistike.
- **Përkthyes / guida ndërkombëtare:** sigurojnë përkthimin e interpretimin kulturor dhe mbështesin ekipet në terren.
- **Shoferët lokalë dhe ndihmësit logjistikë:** sigurojnë transportin e vizitorëve, ullinjve dhe vajit, duke ofruar punësim sezonal.
- **Përpunuesit lokalë të vajit:** pranojnë e përpunojnë ullinjtë, demonstrojnë procesin, sigurojnë standardet dhe paketojnë vajin nën markën lokale.

## **XI. Tregu për vajin dhe marka “Olive Heritage Himara”**

---

Përveç aspektit përjetues, projekti krijon një kanal të qëndrueshëm marketingu për vajin e prodhuar, në dy nivele.

**Në tregun lokal (Himarë–Vlorë–Sarandë):** vaji shitet drejtpërdrejt në pikat e agroturizmit, restorante e bujtina, prezantohet në evente e panairë gastronomike dhe promovohet në pikat turistike si “produkt me histori”.


**Në tregun kombëtar (Tiranë dhe qytetet kryesore):** synohen partneritete me tregtarë artizanalë e markete organike, paketim nën markën “Olive Heritage Himara” si vaj artizanal i kufizuar me origjinë gjeografike, dhe shtrirje në platforma online.

Kështu krijohet një cikël i plotë prodhimi, përpunimi e shitjeje, që e kthen vajin nga produkt lokal në ambasador kombëtar të Himarës. Vaji i marrë nga vizitorët (20–25%) shndërrohet në një rrjet të vogël ambasadorësh të produktit në tregjet e huaja.

## XII. Buxheti i detajuar

Faza pilot zbatohet me një buxhet total orientues prej 5.000.000 Lekë (rreth 50.000 EUR). Buxheti mbulon organizimin e ciklit intensiv me grupin e vizitorëve, akomodimin, logjistikën bujqësore, përpunimin e vajit, festën dhe dokumentimin. Struktura është ndërtuar për shpërndarje të drejtë të burimeve, transparencë financiare dhe mbështetje direkte për komunitetin.


**Buxheti sipas zërave (Total 5.000.000 Lekë)**



| Zëri                   | Përshkrimi                                                                                                  | Kosto (Lekë) |
|------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| Akomodim & ushqim      | Pagesë për familjet pritëse gjatë qëndrimit (mëngjes, drekë e darkë tradicionale) dhe shërbime mikpritjeje. | 1.300.000    |
| Koordinim & ekspertizë | Pagesa për ekspertin agrar, ekspertin e kulturës, guidat, përkthyesit, ndihmësit dhe menaxhimin.            | 800.000      |
| Festa e Ullirit të Ri  | Çadra e ngrohur, skenë, dekor, komunikim publik, ftesa, degustime, çmime e certifikata.                     | 650.000      |
| Përpunimi në fabrikë   | Shtrydhje, filtrim, depozitim, mbushje në shishe; etiketim e ambalazhim nën markën lokale.                  | 500.000      |
| Dokumentar & promovim  | Xhirime profesionale, intervista, montazh, video për rrjete sociale; përkthime dhe titra.                   | 500.000      |
| Transport & logjistikë | Transport i vizitorëve, pajisjeve dhe ullinjve mes fshatrave e fabrikës; karburant e automjete.             | 450.000      |
| Vegla pune & materiale | Rrjeta, doreza, thasë, shporta, kova, ujë, mbrojtje dielli, etiketa dhe materiale identifikuese.            | 300.000      |
| Ushqim në terren       | Drekat e përbashkëta për vizitorët e fermerët gjatë ditëve të vjeljes.                                      | 250.000      |
| Rezervë (5%)           | Kosto të paparashikuara, sigurime, materiale shtesë ose emergjenca.                                         | 250.000      |
| TOTALI                 |                                                                                                             | 5.000.000    |

### Burimet e financimit (bashkëfinancim)

### Burimet e financimit (bashkëfinancim)



| Burimi               | Shuma            | Përshkrimi                                                                                                                    |
|----------------------|------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Bashkia Himarë (60%) | 3.000.000        | Donator kryesor dhe partner institucional: financon akomodimin, transportin lokal, festën dhe pjesën kryesore të logjistikës. |
| UNDP (40%)           | 2.000.000        | Bashkëfinancues: mbështet zhvillimin e qëndrueshëm rural, dokumentimin, promovimin ndërkombëtar dhe ngritjen e markës.        |
| <b>TOTALI</b>        | <b>5.000.000</b> |                                                                                                                               |

*Shënim: përveç bashkëfinancimit, çdo vizitor paguan një tarifë pjesëmarrjeje që mbulon udhëtimin personal dhe pjesë të shërbimeve. Këto të ardhura të vetëgjeneruara qarkullojnë drejtpërdrejt te familjet pritëse dhe komuniteti, duke forcuar qëndrueshmërinë financiare përtej grantit.*

Struktura e buxhetit është menduar që rreth 80% e fondeve të shkojnë direkt te komuniteti lokal — pagesa për familjet pritëse, fermerët, shërbimet logjistike dhe përpunuesit — ndërsa pjesa tjetër (rreth 20%) përdoret për promovim, dokumentim dhe menaxhim profesional.

### XIII. Rezultatet e pritshme

Projekti synon rezultate të prekshme e të matshme në tri drejtime: mbështetje ekonomike, gjallërim turistik e kulturor dhe forcim i lidhjeve njerëzore.

| Rezultati                         | Përshkrimi                                                                                                     |
|-----------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Aktivizimi i 3+1 qendrave rurale  | Vuno, Pilur, Dhërmi dhe Himarë Qendër shndërrohen nga periudhë e qetë në fazë dinamike bashkëpunimi komunitar. |
| Pjesëmarrja e 30–50 vizitorëve    | Vizitorë vendas e ndërkombëtarë përjetojnë vjeljen dhe prodhimin, duke u bërë ambasadorë të Himarës.           |
| Përfitim për rreth 20 familje     | Familjet pritëse dhe fermerët përfitojnë të ardhura nga akomodimi, ushqimi dhe procesi bujqësor.               |
| Prodhimi i 500–600 litra vaj      | Vaji përpunohet e pakëtohet nën markën lokale dhe shpërndahet simbolikisht (20–25%) te pjesëmarrësit.          |
| Promovimi ndërkombëtar i Himarës  | Përmes mediave, rrjeteve sociale dhe dokumentarit, Himara pozicionohet si shembull i turizmit të qëndrueshëm.  |
| Dokumentar & broshurë trilinguale | Një dokumentar artistik dhe një broshurë në shqip–anglisht–greqisht për edukim, promovim dhe identitet.        |

#### XIV. Treguesit e matshëm dhe monitorimi

Suksesi matet përmes një grupi treguesish të qartë e të verifikueshëm. Fondacioni ndjek monitorimin e vazhdueshëm dhe raporton pranë Bashkisë Himarë dhe UNDP-së, duke siguruar transparencë dhe mësimë për përsëritjen e modelit.

| Treguesi                          | Burimi i verifikimit    | Synimi                |
|-----------------------------------|-------------------------|-----------------------|
| Vizitorë-vullnetarë të përfshirë  | Lista e regjistrimit    | 30–50                 |
| Familje pritëse të përfshira      | Marrëveshje / pagesa    | 15–20                 |
| Fermerë të mbështetur             | Marrëveshje / terren    | ≈ 10                  |
| Vaj ulliri i prodhuar (litra)     | Të dhëna nga fabrika    | 500–600               |
| Net turistike të gjeneruara       | Regjistrat e akomodimit | ≈ 50                  |
| Fshatra & parcela të hartogrfuara | Harta e ullishtave      | 3 fshatra             |
| Pjesëmarrës në festë              | Vlerësim në event       | 300–500               |
| Materiale promovuese              | Produkte të dorëzuara   | Dokumentar + broshurë |
| Fonde që mbeten në komunitet      | Raporti financiar       | ≈ 80%                 |

## XV. Qëndrueshmëria dhe ndikimi afatgjatë

---

Qëndrueshmëria është një nga shtyllat themelore të projektit. Struktura është ndërtuar që nisma të vetëriprodhohet çdo vit, duke gjeneruar të ardhura, bashkëpunime të reja dhe identitet të fortë kulturor.

- **Përsëritja vjetore:** projekti zhvillohet çdo vit gjatë periudhës së vjeljes, me përfshirje të vazhdueshme të familjeve, fermerëve dhe vizitorëve.
- **Zgjerimi gjeografik (Faza II):** modeli shtrihet edhe në fshatrat Kudhës, Qeparo dhe Palasë, duke krijuar një rrjet të bashkuar “rivierë e ullirit”.
- **Diversifikimi i financimit:** kërkohet bashkëfinancim nga programe ndërkombëtare (EU4Culture, Interreg Greece–Albania, IPA III), drejt një modeli ndërkufitar Shqipëri–Greqi.
- **Institucionalizimi i eventit:** “Festa e Ullirit të Ri” përfshihet në kalendarin kulturor vjetor të Bashkisë Himarë dhe financohet çdo vit.
- **Ndikimi afatgjatë:** ruajtja e ullishtave tradicionale, nxitja e agroturizmit gjithëvjetor dhe një ekonomi e gjelbër; rreth 80% e përfitimeve mbeten brenda zonës.

## XVI. Komunikimi dhe promovimi

---

- **Platformë zyrtare digjitale** dhe profile në rrjetet sociale (Facebook, Instagram, YouTube), me përmbajtje të përditësuar mbi aktivitetet, partnerët dhe historitë lokale.
- **Bashkëpunime ndërkombëtare** me agjenci turistike në Itali, Gjermani, Francë dhe Skandinavi, të specializuara në “slow tourism”.
- **Broshurë trilinguale** (shqip–anglisht–greqisht) dhe identitet vizual i unifikuar, me ngjyra të inspiruara nga ulliri dhe deti.
- **Dokumentar dhe fotoreportazh** të publikuara në media kombëtare e evropiane, festivale e panairë; konferencë për shtyp gjatë festës.

## XVII. Analiza e riskut dhe masat zbutëse

Si çdo nismë pilot, projekti përballlet me disa rreziqe të mundshme. Më poshtë paraqiten rreziqet kryesore dhe masat parandaluese e zbutëse.

| Rreziku                                  | Niveli  | Masa zbutëse                                                                                                                  |
|------------------------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Numër i ulët rezervimesh nga vizitorët   | Mesatar | Promovim i hershëm (janar-shtator), partneritete me agjenci "slow tourism" dhe çmime fleksibël për grupin e parë.             |
| Kushte të vështira atmosferike në nëntor | Mesatar | Ditë rezervë në plan (23 nëntor), çadër e ngrohur për festën dhe aktivitete alternative brenda (workshop, degustime, vizita). |
| Mungesë koordinimi me fermerët/familjet  | I ulët  | Marrëveshje paraprake të qarta, roli koordinues i Fondacionit dhe asistencë administrative e Bashkisë.                        |
| Cilësi e ndryshueshme e shërbimeve       | I ulët  | Trajnim i familjeve pritëse, standarde minimale të mikpritjes dhe monitorim i vazhdueshëm.                                    |
| Vonesa në financim                       | Mesatar | Bashkëfinancim i sigurt (Bashkia + UNDP), rezervë buxhetore 5% dhe të ardhura nga tarifat e pjesëmarrësve.                    |
| Pengesa gjuhësore / kulturore            | I ulët  | Përkthyes dhe guida kulturore për çdo ekip; materiale udhëzuese shumëgjuhëshe.                                                |

## XVIII. Kalendari i përgjithshëm

| Periudha                  | Faza       | Aktivitetet kryesore                                                                         |
|---------------------------|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|
| Gusht 2026                | Përgatitje | Angazhimi i komunitetit; pëlqimet; lançimi i fushatës së vizitorëve; kontaktet me partnerët. |
| Shtator 2026              | Përgatitje | Kontraktimi i ekipit; marrëveshjet me fabrikat; harta e ullishtave; plani i punës.           |
| Tetor 2026                | Përgatitje | Guída turistike; ushqimi & akomodimi; fushata ndërgjegjëse; agjenda e festës.                |
| 14–16 Nëntor              | Zbatim     | Mbërritja, akomodimi dhe trajnimi i vizitorëve.                                              |
| 17–23 Nëntor              | Zbatim     | Vjelja e ullirit në Vuno, Pilur, Dhërmi.                                                     |
| 24–26 Nëntor              | Zbatim     | Prodhimi i vajit në fabrikat e Himarës.                                                      |
| 27–29 Nëntor              | Zbatim     | Paketim, markim, broshura, stenda dhe guidë turistike.                                       |
| 30 Nëntor                 | Kulmi      | Festa e Ullirit të Ri dhe ndarja e çmimeve.                                                  |
| Dhjetor 2026 – Janar 2027 | Raportim   | Raportimi teknik e financiar; vlerësimi i impaktit; planifikimi i Fazës II.                  |



*Aplikuesi: Fondacioni “Rruga me Pisha” — organizatë shqiptare e themeluar në vitin 2001.*

Kontakt: rrugamepisha@gmail.com • +355 68 200 5355

# OLIVE HERITAGE HIMARA

## Përmbledhje e buxhetit të projektit

Total 5.000.000 Lekë (~50.000 EUR) · Bashkëfinancim: Bashkia Himarë 60% + UNDP 40%

| Buxheti total | Festa e Ullirit | Akomodim & |
|---------------|-----------------|------------|
| 5.000.000 L   | 900.000 L       | 1.100.0    |

### Buxheti sipas zërave kryesorë

| Kodi | Kategoria                            | Kosto (Lekë) |
|------|--------------------------------------|--------------|
| A    | Personel & koordinim                 | 800.000      |
| B    | Faza përgatitore                     | 300.000      |
| C    | Akomodim & ushqim (familjet pritëse) | 1.100.000    |
| D    | Operacionet e vjeljes                | 400.000      |
| E    | Përpunim & paketim i vajit           | 300.000      |
| F    | Transport & logjistikë               | 350.000      |
| G    | Festa e Ullirit të Ri                | 900.000      |
| H    | Dokumentim, markë & promovim         | 450.000      |
| I    | Monitorim, raportim & administratë   | 150.000      |
| J    | Rezervë (kontingjenca)               | 250.000      |
|      | TOTALI                               | 5.000.000    |

### Financimi

|                                       |  |  |  |           |
|---------------------------------------|--|--|--|-----------|
| Bashkia Himarë (60%)                  |  |  |  | 3.000.000 |
| UNDP (40%)                            |  |  |  | 2.000.000 |
| Fondet që mbeten në komunitet (synim) |  |  |  | ≈ 80%     |

## Buxheti sipas grupeve funksionale

Pamje e nivelit të lartë e shpërndarjes së buxhetit

| Grupi funksional                       | Kosto (Lekë)     | %             |
|----------------------------------------|------------------|---------------|
| Komuniteti & mikpritja (C+D)           | 1.500.000        | 30,0%         |
| Personel, koordinim & përgatitje (A+B) | 1.100.000        | 22,0%         |
| Festa e Ullirit të Ri (G)              | 900.000          | 18,0%         |
| Përpunim, transport & logjistikë (E+F) | 650.000          | 13,0%         |
| Promovim & dokumentim (H)              | 450.000          | 9,0%          |
| Administratë & rezervë (I+J)           | 400.000          | 8,0%          |
| <b>TOTALI</b>                          | <b>5.000.000</b> | <b>100,0%</b> |